



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.126

4 shtator

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Rregullore e MPPT
nr.3602, datë 18.8.2011

Mbi mënyrën e ngarkimit të mallrave në vagonët
hekurudhorë.....

5467

RREGULLORE
Nr.3602, datë 18.8.2011

MBI MËNYRËN E NGARKIMIT TË MALLRAVE NË VAGONËT HEKURUDHORE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 66 të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

Duke adaptuar: direktivat e Bashkimit Ndërkombëtar të Hekurudhave (UIC), aneksin II të “Rregullores ndërkombëtare të mjeteve” (RIV), lidhur me parimet dhe metodat e ngarkimit të mallrave në vagonët hekurudhorë.

Me qëllim: rregullimin, disiplinimin, monitorimin, transparencën e veprimtarisë së ushtruar në ngarkimin e vagonëve hekurudhorë në përputhje me llojet e mallrave dhe tipat e mjeteve hekurudhore të transportit të mallrave, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit nxjerr këtë

RREGULLORE
KAPITULLI I

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin dhe vendosjen e rregullave dhe parimeve të përgjithshme për ngarkimin e mjeteve hekurudhore të transportit të mallrave.

Neni 2
Zbatimi

Kjo rregullore është hartuar për miradministrimin e përdorimit reciprok të vagonëve në trafikun ndërkombëtar dhe kombëtar, në zbatim të legjislationit ndërkombëtar të fushës.

Zbatimi i saj nga subjektet fizike dhe juridike vendase rregullon veprimtarinë e sigurt të shfrytëzimit të trafikut hekurudhor dhe parandalon dëmtimin e mallrave dhe vagonëve. Transportuesi është përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Në rast se transportuesi nuk krijon bindje në drejtim të sigurisë së transportit, atëherë ndërmarrja hekurudhore konsideron të papërshtatshme mënyrën e ngarkimit të përcaktuar në këtë rregullore dhe refuzon nisjen e vagonit hekurudhor për në destinacion.

Neni 3
Struktura dhe fusha e zbatimit

Rregullorja është hartuar në dy volume si më poshtë:

Volumi 1. Përmban parimet e përgjithshme lidhur me ngarkimin dhe sigurimin e mallit. Këto rregulla janë të detyrueshme.

Volumi 2. Përmban rregullat e ngarkimit të mallrave, të specifikuara sipas llojit të mallit, në pajtim me parimet e përcaktuara në volumin 1. Llojet e tjera të ngarkimit dhe sigurimit të mallit janë të lejuara, me kusht që ato të plotësojnë kushtet e përcaktuara në volumin 1. Këto rregulla, gjithashtu, zbatohen kur vagonët janë pajisur me pajisje të veçanta, që garantojnë sigurinë e shfrytëzimit në një mënyrë tjetër.

Për metodat e reja të ngarkimit, kjo bën të domosdoshme demonstrimin që ngarkesa të jetë mjaftueshmërisht e siguruar si për:

- Ngarkesat që dalin jashtë parakolpeve në mënyrë gjatësore, testi sipas tabelës 4;
- Ngarkesat që vendosen në mënyrë tërthore gjatë testit në lëvizje ose testit me pajisje dinamike.

Siguria e shfrytëzimit duhet që në çdo rast të jetë e siguruar. Kjo rregullore ngarkimi është e vlefshme për trenat që qarkullojnë deri në 120 km/orë.

Neni 4 **Mallrat dhe ngarkesat**

Në kuptimin e llojit të ngarkesave mallrat mund të ndahen në:

1. Mallra masive (inerte, hekurishte, gjysmëfabrikante, mbetje, lëndë druri etj.).
2. Objekte individuale (mjete, arka, makineri, njësi të transportit të kombinuar etj.).
3. Objekte të formuara si njësi dhe që trajtohen si njësi individuale gjatë transportit (pako, dengje, lidhje, stiva etj.).

Në kuptimin e njësisë apo të mjeteve të transportit (vagon, kontejner etj.) mallrat mund të jenë:

1. Të shpërndara në mënyrë uniforme.
2. Të siguruara dhe të mbrojtura nga ndikimi i erës.
3. Të mbrojtura kur janë të dëmtueshme dhe transportohen me paketim të përshtatshëm.

Kushtet përkatëse të volumnit 1 zbatohen në përputhje me llojin e ngarkimit dhe garantimin e sigurimit të mallit në kuadrin e transportit të kombinuar të njësive transportuese, të cilat duhet të jenë të përshtatura sipas llojit të mallit që do të ngarkohet. Nga parimet e sipërpërmendura përjashtohen ngarkesat, të cilat janë të predispozuara për rrëshqitje (zhvendosje), që nuk lejohen në njësitë e transportit të kombinuar.

Neni 5

Transporti i mallrave të rrezikshme bëhet sipas dispozitave të:

- a) rregullores për transportin ndërkombëtar hekurudhor të mallrave të rrezikshme (RID);
- b) akteve ligjore e nënligjore kombëtare për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme.

Neni 6 **Formimi i njësive të mallrave**

Mallrat pakëtohen apo bashkohen si njësi për transport si më poshtë:

- Bashkohen ose lidhen me shirita çeliku, tela çeliku, rripa sintetikë ose të endur (këto duhet të jenë të paratensionuar) me një forcë shtrënguese që të paktën është:
 - 5 kN për mallra në paleta, me peshë deri 500 kg.
 - 7 kN për mallra në paleta mbi 500 kg, lëndë druri e sharruar, dengje celuloze, kartonë, kompensatë etj.
 - 10 kN për traversa druri, pllaka betoni etj.
 - 14 kN për pakot e lidhjeve me fletë llamarinash çeliku, koli me shufra, rulona çeliku, pako kompensatash dhe pllaka tallashi të presuara, blloqe gurësh etj.
 - 20 kN për lidhje me disa pako llamarinash çeliku.
 - 40 kN për lidhjen së bashku të tubave prej çeliku, kur këto janë vendosur (sistemuar) në formë bishtdallëndysheje dhe fiksohen me tako.

Numri i fashetave lidhëse së paku është 2, të shpërndara rregullisht. Ky numër është në vartësi të llojit të mallit. Në rastin e lidhjes së disa bobinave prej llamarinash çeliku duhen të paktën 4 lidhje.

Në rastin e veshjes së mallit të vendosur në paletë me fletë plastike dhe me peshë deri afërsisht 1.000 kg, pikat mbështetëse të paletës inkludohen në veshjen plastike. Trashësia e elementit veshës plastik në përgjithësi duhet të jetë 0.15 mm.

KAPITULLI II

Neni 7

Përdorimi i vagonëve dhe transportimi i njësive të transportit

1. Tregues të përgjithshëm

Asnjë ndryshim konstruktiv nuk duhet të bëhet në vagonët dhe njësitë e transportit, të tilla si: hapje vrimash, saldime në pajisjet, prerje të pjesëve me llamba saldimit etj., pa pëlqimin miratimin e pronarit të mjetit.

Në rastet kur në sipërfaqen e dyshemesë së vagonit është depozituar borë ose ka ngrirë, ajo duhet larguar më parë se të fillojë operacioni i ngarkimit të mallrave.

Mbas ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave:

- Dyert, spondat, çatia, kapakët, krahët, valvulat (rubinetet) etj., duhet të mbyllën e të sigurohen.

- Spondat, kapakët duhet të vendosen në pozicionin e duhur vertikal, kanatet në pjesën e poshtme (për vagonët me shkarkim nga poshtë) duhet të sigurohen, p.sh., duke përdorur direkt bllokuesit. Në asnjë rast nuk duhet të shkelet (tejkalohe) gabariti, shih tabelën 3. Çdo shënim, shenja dhe etiketa duhet të jenë të shikueshme dhe të lexueshme.

- Pjesë të tjera të zhvendosshme dhe/ose të luajtshme dhe pajisjet e sigurimit (p.sh. krahët) duhet të fiksohen me pajisjet e duhura dhe të jenë në kushtet e përcaktuara.

Mbas ngarkimit, krahët duhet rregullisht të jenë të vendosura në pozicion vertikal (me përjashtim në mjetet që përdoren në pajtueshmëri me volumin 2).

Kur me marrëveshje të drejtuesve të NH (ndërmarrje hekurudhore), pjesët e zhvendosshme e të lëvizshme nuk janë vendosur në pozicionin e duhur, ato duhet të jenë vendosur në një mënyrë të tillë që të mos rrezikojnë sigurinë e shfrytëzimit.

2. Dyshemeja

Mallrat që kanë prirje të dëmtojnë sipërfaqen ngarkuese për arsye të sipërfaqes së vogël mbështetëse që kanë, duhet të ngarkohen duke pasur parasysh formën e peshës e tyre të mbështetura në trarë dërrase. Kjo kërkohet kur gjatë veprimit për ngarkim në dyshemenë e vagonit tejkalohe vlerat e mëposhtme:

- 10 kg/cm² për vagonët që kanë shënimin UIC.

Automjetet që ngarkohen në vagonë platformë, me ngarkesë 5.000 kg për aks është i lejueshëm ngarkimi pa mbështetje me trarë ose pajisje tjetër.

Ngarkesa maksimale e lejueshme në dysheme në rastin e makinerive të transportit industrial është:

- 3.000 kg për aks në rastin e ngarkimit direkt në vagon.

- 2.760 kg për aks në rastin e ngarkimit në kontejner. Në çdo dy pika mbështetëse të ngarkesës, distanca midis tyre duhet të jetë së paku 760 mm.

3. Kazani, spondet dhe dyert

Mallrat që janë në kontakt me spondet nuk duhet të ushtrojnë forcë mbi këto, mbasi mund t'i dëmtojnë ose mund të rrezikojnë sigurinë e lëvizjes.

Dyert e lëvizshme, spondet, krahët dhe çatia nuk duhet të bllokohen gjatë ngarkimit. Mundësisht ato duhet të hapen (lëvizin) pa probleme. Dyert e lëvizshme e spondet kanë për qëllim vetëm sigurimin e ngarkesës dhe forca që ushtron ngarkesa mbi to duhet të jetë brenda limitit. Malli në kontakt me këto nuk duhet të lejohet të anohet ose të tundet sa majtas ose djathtas.


Malli nuk duhet të vendoset e mbështetet në pjesën e sipërme të spondeve. Vetëm mallrat që ngarkohen në stivë që janë në kontakt me krahët mund të takojnë spondat.

4. Pajisjet e mbulimit


Vagonët me mbulesë janë të përdorshme për të mbrojtur mallin nga agjentët atmosferikë dhe nuk kanë për qëllim të sigurojnë mallin në konceptin e sigurisë së lëvizjes. Me qëllim që të sigurohet hapja dhe mbyllja e pajisjes së mbulimit, ajo duhet që të mos ketë kontakt me mallin.

5. Krahët

Mallrat që mbështeten te krahët nuk duhet të ushtrojnë forcë të tillë që të shkaktojnë deformacione të përhershme tek ato. Krahët mund të lëvizin nga pozicioni vertikal në vartësi të hapësirave që ka nyja e suportit. Krahët e rrotullueshëm, nëse është e domosdoshme, duhet të jenë të siguruara me pajisje (tako druri).



Kur mallra cilindrike (p.sh. tuba) ngarkohen me stiva, ose si në figurën e mëposhtme, dhe që takojnë te krahët dhe kur lartësia e ngarkesës e kalon gjysmën e lartësisë së krahëve, atëherë çiftet e krahëve përballë duhet të jenë të lidhura me fasheta. Fashetat që përdoren duhet të kenë një shtrëngim së paku 1.000 daN.



Lidhjet

Krahe te rrotullueshem

Neni 8

Pajisjet e sigurimit (unazat, ganxhat, sythet) të mallit me vagonin

Për lidhjen direkte ose indirekte të mallrave me vagonin, sigurimi duhet të bëhet nëpërmjet unazave të sigurimit, sythave ose ganxhave të përgatitura nga shufra çeliku me diametër së paku 16 mm. Lidhja direkte mund të bëhet midis dy pikave të sigurimit (lidhjes) për mallra me peshë si më poshtë:

- deri në 10 tonë në vagonë platformë;
- deri në 5 tonë në vagon të mbyllur.

Sythet e unazat të përcaktuara për sigurimin e llamarinave në vagonë mund të përdoren si më poshtë:

- për lidhje direkte të mallrave me peshë deri 2 tonë;
- për lidhje indirekte të mallrave me peshë deri 4 tonë.

Në qoftë se nuk ka pika (vende) të lidhjes, lidhja mund të bëhet duke shfrytëzuar përdorimin e vendeve të përshtatshme në vagon. Megjithatë nuk është e lejueshme të shfrytëzohen si pika lidhje pjesë, të tilla si: mekanizmat lëvizës ata të amortizimit, as në karretë, mbajtëset e sinjaleve, dyert e pajisjet e dymve, kapakët ose dritaret e pajisjet e tyre, parmakët, shkallët etj. Pajisjet e tërheqjes, parakolpet, pajisjet e frenimit, shasia etj., nuk lejohen të përdoren si vende për laqe.

Neni 9

Ndarëset e sigurimit të mallit

1. Ndarëset e ndërmjetme

Ndarëset e ndërmjetme shërbejnë për të siguruar mallrat që transportohen me copë. Ndarëset e ndërmjetme sigurojnë mallrat kundrejt prirjes për anim në drejtimin gjatësor në vagon, pra ato reduktojnë ose zgjidhin plotësisht këtë problem.

Në vagonët standardë deri në 5 tonë mall, mund të ngarkohen duke pasur vetëm një ndarëse të ndërmjetme; deri në 7 tonë mall mund të vendosen 2 ndarëse, që janë kundrejt njëri-tjetrit. Në këtë konfiguracion, ngarkesa mund të jetë në kontakt me ndarëset në një sipërfaqe së paku 2.400 mm në gjatësi dhe 700 mm në lartësi.

2. Pajisjet mbështetëse të ngarkimit

Këto pajisje përgjithësisht përdoren për ngarkimin e bobinave të lllamarinave të çelikut. Ato janë, gjithashtu, të përshtatshme për ngarkimin e mallrave të ngjashme, të tilla si tamburet e kablllove. Diametri i lejueshëm dhe pesha duhet të verifikohet në çdo rast të përdorimit të këtyre pajisjeve. Pajisjet ekzistuese për sigurimin anësor (pajisjet e sigurimit) duhet të jenë të vendosura në pozicion pune dhe në numrin e duhur që të lidhin mallin me pajisjen mbështetëse.

3. Pajisjet indirekte të sigurimit

Këto lloje pajisjesh përgjithësisht përdoren për sigurimin e tubave, mallrave të rënda dhe lënde druri (trupa etj.) të sharruar. Pajisjet shtrënguese duhet të jenë të tërhequra mirë dhe të shtrëngojnë mallin, dhe mbas shkarkimit, kur nuk përdoren, ato duhet të vendosen në vendin e duhur.

4. Pajisjet e sigurimit të rrotave të automjeteve (takot)

Këto lloj pajisjesh përdoren për sigurimin e automjeteve. Ato vendosen në sipërfaqen ngarkuese në drejtimin gjatësor të vagonit dhe sigurojnë ruajtjen e pozicionit të mjetit për të mos lëvizur. Kur mjeti është siguruar, këto pajisje duhet të bllokojnë rrotat që të mos lëvizin. Mbas shkarkimit këto pajisje vendosen në vendin e duhur.

KAPITULLI III

Neni 10

Ngarkimi i vagonëve

Kategoria e linjave

Linjat hekurudhore klasifikohen në kategori sipas ngarkesës në aks, të lejueshme, dhe masës për metër linear si më poshtë:

Kategoria e linjës	Maksimumi i peshës në aks (tonë/aks)	Maksimumi i peshës për metër linear (tonë/metër)
A	16 t	5.0 t/m
B1	18 t	5.0 t/m
B2	18 t	6.4 t/m
C2	20 t	6.4 t/m
C3	20 t	7.2 t/m
C4	20 t	8.0 t/m
D2	22.5 t	6.4 t/m
D3	22.5 t	7.2 t/m
D4	22.5 t	8.0 t/m

Çdo administrues i infrastrukturës hekurudhore përcakton kategoritë e linjave që i përgjigjen treguesve të sipërpërmendur për trafikun kombëtar dhe ndërkombëtar. Ndërmjet administruesve të infrastrukturave hekurudhore të vendeve të ndryshme mund të miratohen marrëveshje të veçanta për trafik specifik, për linja ose vagonë të veçantë. Në të njëjtën mënyrë, transportuesit hekurudhorë mund të përfundojnë marrëveshje të veçanta për ngarkimin e vagonëve për trafikun e brendshëm. Qarkullimi i tyre mund të rregullohet sipas rregullave specifike.

Neni 11

Kapaciteti maksimal i ngarkimit

Limiti maksimal i ngarkimit është i shënuar në vagon. Si limit maksimal i ngarkimit duhet të konsiderohet vlera më e vogël sipas kategorisë së linjës ku do të kryhet transporti. Ky kufi nuk duhet të kalojë.

Shembull

	A	B	B2	C2	C3 C4
	00,0	00,0			
S	00,0				

Shembull për marrëveshje midis hekurudhave


		C	D
0BB	S	00,0	00,0
DB	000	00,0	00,0
SNCF FS CFI	000	00,0	00,0

1. Shih volumin 2 për detaje.


Neni 12

Shpërndarja e ngarkesës në vagon

Ngarkesa duhet të shpërndahet aq sa është e mundur në mënyrë të barabartë në vagon, pa tejkaluar maksimumin e peshës në aks. Shpërndarja e ngarkesës duhet të bëhet e tillë sipas raporteve të mëposhtme dhe nuk duhet të tejkalohet:



- Kalkulimi i raporteve të shpërndarjes së ngarkesës për aks



$$E1 = \frac{P \times a}{l} + \frac{T}{2}$$

$$E2 = (P + T) - E1$$

Pesha bruto totale

Shembull: $P = t$

$$a = 4.5 \text{ m}$$

$$E1 = \frac{20 \times 4.5}{8} + \frac{12.2}{2} = 17.35 \text{ t}$$

$$E2 = 20 + 12.2 - 17.35 = 14.85 \text{ t}$$

$$\text{Raporti i peshës për aks} = E1/E2 = \frac{17.35}{14.85} = \frac{1.18}{1} < \frac{2}{1}$$

P = pesha e ngarkesës në tonë

T = tara e vagonit në tonë

$E1, E2$ = pesha për aks në tonë


a, l = distancat në m

$T = 12.2 \text{ t}$

$l = 8 \text{ m}$

Konkluzion. Ngarkesa mund të jetë e pranueshme, derisa raporti i ngarkesës për aks është më i vogël se 2:1. Megjithatë, kjo nuk mund të jetë e pranueshme në linjat e kategorisë A, përderisa pesha për aks ($E1$) është më e madhe se 16 tonë.

- Për vagonët me karreta, raporti prej 3:1 ndërmjet ngarkesave për karretë;
- Kalkulimi i raporteve të ngarkesave për karretë.



$$E1 = \frac{(P1 \times a) + (P2 \times b) + (P3 \times c) + T}{2}$$

$$E2 = (P1 + P2 + P3 + T) - E1$$

Pesha bruto total

P1, P2, P3 = pesha e çdo ngarkese në tonë

T = pesha e tarës në tonë

E1, E2 = pesha për karretë në tonë

a, b, c, l = distanca në metër

Shembull:

$$P1 = 20 \text{ t} \quad P2 = 8 \text{ t} \quad P3 = 2 \text{ t} \quad T = 24 \text{ t}$$

$$a = 11.5 \text{ m} \quad b = 7 \text{ m} \quad c = 2.5 \text{ m} \quad l = 13 \text{ m}$$


$$E1 = \frac{20 \times 11.5 + 8 \times 7 + 2 \times 2.5}{13} + \frac{24}{2} = 34.38 \text{ t, ose } 17.19 \text{ t për aks}$$

$$E2 = 20 + 8 + 2 + 24 - 34.38 = 19.62 \text{ t, ose } 9.81 \text{ tonë për aks}$$

Raporti i ngarkesës për karret: $\frac{E1}{E2} = \frac{34.38}{19.62} = 1.75 < 3$

Konkluzion. Ngarkesa mund të jetë e pranueshme derisa raporti i ngarkesës për karretë është më i vogël se 3:1. Megjithatë, kjo ngarkesë mund të jetë e pranueshme në linjat e kategorisë A, përderisa pesha për aks (te karreta E1) është më e madhe se 16 tonë.


- Raporti prej 1.25 deri 1 *) midis akseve (majtas/djathtas) për aksin e dhënë.



*) Vlera limit e lejuar e diferencës së ngarkesës në aks është e respektuar kur qendra e gravitetit spostohet në drejtim tërthor jo më tepër se:

- 10 cm afërsisht kur është ngarkesa e plotë;
- 15 cm afërsisht kur është gjysmë e ngarkuar.

Kalkulimi i spostimit maksimal të qendrës së gravitetit të ngarkesës në drejtimin tërthor të vagonit.



R1, R2 = pesha për aks në tonë

E1, E2 = pesha për aks ose karretë në tonë (llogaritur si për aksin 1 ose 2)

T = pesha e vagonit në tonë

PA = pesha e ngarkesës në aks ose karretë në rastin konkret në tonë = $E1, E2 - \frac{T}{2}$

s = distanca e qendrës së gravitetit të ngarkesës nga qendra e vagonit në drejtimin gjatësor, në m

Q = ngarkesa sipas tabelës A, B, C për kategorinë e linjës, në tonë

M = pesha bruto e vagonit ($T + Q$)


Kushti

$$\frac{RI}{R2} \leq \frac{10}{8} \quad \text{dhe} \quad s \leq \frac{1}{12} (1 + \frac{T}{2PA})$$

Neni 13

Ngarkesa individuale

Pesha e ngarkesës individuale maksimale e lejueshme është e shënuar në tabelën që i bashkëngjitet vagonit. Kjo vlerë përcaktohet nga pozicioni dhe gjatësia e ngarkesës (në veçanti në vagonët platformë).




Një dallim bëhet midis dy llojeve të pozicionimit:

a) - Mallra që ngarkohen në vagonët platformë, qoftë direkt ose së paku me katër tako në vagon. Në qoftë se aksi i takove fundore është në një rrafsh ose jashtë aksit të qendrës së karretës, sipërfaqja mbështetëse gjatësore duhet konsideruar që të jetë e njëjtë me gjatësinë e përgjithshme të ngarkesës.

- Maksimumi i sipërfaqes mbështetëse tregohet me shenjën ——— përkundrejt distancës korresponduse.


- Sipërfaqja mbështetëse = I .



b) Ngarkesa vendoset vetëm në dy tako.

- Maksimumi i sipërfaqes mbështetëse tregohet me shenjën ——— përkundrejt distancës korresponduse.

- Sipërfaqja mbështetëse = I .



Ngarkesat e këtij lloji që mbështeten jashtë aksit ose të aksit të karretës janë të pranueshme në qoftë se ato i përgjigjen vlerave të treguara në tabelën e ngarkimit që është individuale për tipin e vagonit.

Në mungesë të shenjës — ngarkesa mundet të vendoset në dy tako, me kusht që vlera e dhënë me shenjën — të mos tejkalohet.

Vlerat e treguara në tabelat për ngarkesat individuale janë llogaritur për një sipërfaqe mbështetje me gjatësi prej:

- Të paktën 2 m (tabela me një vijë kufizuese).

	m	t	z
a-a	2	35	40
b-b	3	37	47
c-c	5	43	56


- Të paktën 1.2 m (tabela me dy vija kufizuese).

	m	t	z
a-a	2	35	40
b-b	3	37	47
c-c	5	43	56

Kur fundi i ngarkesës ose aksi i takove bie midis dy përcaktimeve, ngarkesa e lejueshme llogaritet me interpolim.

Shembull kalkulimi. Pesha e lejuar për ngarkim me sipërfaqe mbështetëse 6.5 m.

A	B1	B2	C
44 t	50 t	52 t	60



	m	t	z
a-a	2	35	40
b-b	3	37	47
c-c	5	43	56
d-d	7	51	58
e-e	9	60	60
f-f	12	60	28

Diferenca në gjatësi: $7\text{ m} - 5\text{ m} = 2\text{ m}$

Diferenca në peshë: $51\text{ t} - 43\text{ t} = 8\text{ t}$

Në qoftë se ngarkesa kalon përtej përcaktimit c-c me 1.5 m, pesha e lejueshme për seksionin që tejkalohet është:

$$\frac{8\text{ t}}{2\text{ m}} \times 1.5\text{ m} = 6\text{ t}$$

kur ngarkesa është vendosur direkt në dyshtemenë e vagonit, ajo mund të ketë peshën prej:

$$43\text{ t} + 6\text{ t} = 49\text{ t}$$

Shembull kalkulimi

Ngarkesa e lejueshme e një mase të koncentruar në mesin e vagonit e vendosur direkt në dyshteme midis pikave a - a (fig.1).




Fig. 1

Fig. 2

	m	t	z
a-a	2	35	40
b-b	3	37	47
c-c	5	43	56
d-d	7	51	58
e-e	9	60	60
f-f	12	60	28

Në rast se malli është vendosur direkt në dyshteme, në këtë rast masa e lejuar tregohet poshtë shenjës — në tabelën e fig. 2, që mund të ngarkohet në pjesën e mesit të vagonit.

Për mallrat që ngarkohen midis pikave a - a, masa maksimale e lejueshme kalkulohet si në vijim:

1. Marrim masën teorike të lejueshme në qendër të vagonit. Vlera kalkulohet nisur nga vlera e treguar në fig. 2 në shenjën a - a (=35 t) dhe korrektohet me koeficientët e tabelës së mëposhtme:

Distanca midis akseve ose qendres se karretesve a-a	6 m	7 m	8 m	9 m	10 m	11 m	12 m	13 m	14 m	15 m	16 m	17 m
1,5 m	0,88	0,89	0,90	0,92	0,93	0,93	0,94	0,94	0,95	0,95	0,95	0,96
2,0 m	0,83	0,86	0,88	0,89	0,90	0,91	0,92	0,92	0,93	0,93	0,94	0,94
2,5 m	0,79	0,82	0,84	0,86	0,86	0,89	0,90	0,90	0,91	0,92	0,92	0,93
3,0 m	0,75	0,78	0,81	0,83	0,85	0,86	0,88	0,88	0,89	0,90	0,91	0,91

Kjo jep masën teorike të lejueshme në qendër të vagonit:

$$0.89 \times 35 \text{ t} = 31.15 \text{ t}$$

2. Kjo masë rritet me një vlerë, e cila varet nga distanca a – a dhe gjatësia e mallit:

- distanca a – a = 2 m;

- gjatësia e mallit = 1.5;

- distanca midis masës a – a — dhe masa teorike e lejuar në qendër të vagonit.

$$35 \text{ t} - 31.15 \text{ t} = 3.85 \text{ t}$$

$$\frac{3.85 \text{ t} \times 1.5 \text{ m}}{2 \text{ m}} \approx 2.9 \text{ tonë}$$

$$2 \text{ m}$$

Maksimumi i lejueshëm i ngarkimit për masën që vendoset direkt në dyshtemenë e vagonit do të jetë: 31.2 t

$$6 + 2.9 \text{ t} = 34.1 \text{ t}$$

3. Në këtë rast ajo nuk ka kufizime në lidhje me kategorinë e linjës (fig. 3).

	A	B	C
s	44.0	52.0	60.0

Shembull kalkulimi:

Ngarkesa e lejueshme e masës, vendosur në dy pika mbështetëse midis pikave a – a e centruar në aksin gjatësor të vagonit (fig. 1).




Fig. 2

	m	t
a-a	2	35
b-b	3	37
c-c	5	43
d-d	7	51
e-e	9	60
f-f	12	60

- Meqenëse malli është vendosur në dy pika mbështetëse, gjejmë masën e treguar poshtë shenjë që aplikohet si masë e përqendruar në mesin e vagonit (fig. 2).

- Gjatësia e sipërfaqes mbështetëse duhet të konsiderohet distanca e matur midis akseve të dy pikave mbështetëse.

- Duke qenë se pikat e mbështetjes janë midis pikave a – a, maksimumi i masës së lejueshme kalkulohet si më poshtë:

1. Marrim masën teorike të lejueshme në qendër të vagonit. Vlera kalkulohet nisur nga masa e treguar në shenjen a – a (= 40 t) dhe korrektohet me koeficientët e tabelës së mëposhtme:

Distanca midis akseve ose qendres se karretesve a-a	6 m	7 m	8 m	9 m	10 m	11 m	12 m	13 m	14 m	15 m	16 m	17 m
1,5 m	0,75	0,79	0,81	0,83	0,85	0,86	0,87	0,88	0,89	0,90	0,91	0,91
2,0 m	0,67	0,71	0,75	0,78	0,80	0,82	0,83	0,85	0,86	0,87	0,88	0,88
2,5 m	0,58	0,64	0,69	0,72	0,75	0,77	0,79	0,81	0,82	0,83	0,84	0,85
3,0 m	0,50	0,57	0,63	0,67	0,70	0,73	0,75	0,77	0,79	0,80	0,81	0,82

Kjo jep masën teorike të lejueshme në qendër të vagonit

$$0.78 \times 40 \text{ t} = 31.2 \text{ t}$$

2. Kjo masë rritet me një vlerë, e cila varet nga distanca a – a dhe gjatësia e mallit:

- distanca a – a = 2;

- distanca midis pikave të mbështetjes = 1.5 m;

- diferenca midis masës a – a —————
vagonit:

dhe masës teorike të lejuar me qendër të

$$40 \text{ t} - 31.2 \text{ t} = 8.8 \text{ t}$$

$$\frac{8.8 \times 1.5 \text{ m}}{2 \text{ m}} \approx 6.6 \text{ t}$$

Maksimumi i lejuar i ngarkimit për masën që vendoset në dy pika mbështetëse do të jetë:

$$31.2 + 6.6 \text{ t} = 37,8 \text{ t}$$

3. Në këtë rast, ajo nuk ka kufizime në lidhje me kategorinë e linjës (fig. 3).

	A	B	C
s	44.0	52.0	60.0

Neni 14



Verifikimi i shpërndarjes së ngarkesës

Shpërndarja e ngarkesës mund të verifikohet sipas:

- kalkulimeve (shih nenin 13);
- diferencës në peshë për aks ose karretë të vagonit.

Pesha e ngarkesës nuk është shpërndarë në rregull nëse:

- distanca nga sipërfaqja e kokës së shinës deri tek aksi i parakolpeve është më pak se 940 mm dhe më tepër se 1065 mm;
- distanca midis pjesës së sipërme të kavallotës së balestrës dhe takos së traut gjatësor të shasisë është më e vogël se 15 mm (shih vizatimet e mëposhtme).



KAPITULLI IV



Neni 15

Dimensionet e lejuara të ngarkesës

1. Standardet e ngarkesave dhe kufizimet


Standardet (gabariti) e ngarkesave (tabela 1 e gabariteve të ngarkimit) është një kërkesë që duhet respektuar dhe diktuar nga ndërtimet në linjën hekurudhore.

Ngarkesa nuk duhet të kapërcejë gabaritin minimal në të gjithë gjatësinë e itinerarit. Zbatimi i gabaritit të ngarkesës duhet të matet nga niveli i kokës së shinës (rrafshi horizontal) në linjë të drejtë.



Në llogaritjen e gabaritit merren parasysh dhe kufizimet në gjerësi që lindin gjatë kalimit të mjeteve në linjat në kthesë (tabela 2), si:

1. Nga ana e brendshme e kthesës, midis aksit dhe qendrës së karretës; dhe
2. Nga ana e jashtme e kthesës, që rezulton nga ripozicionimi i shastisë.




2. Daljet jashtë spondit ballor

Gjatësia e ngarkimit e shënuar në vagon mund të tejkalohet si më poshtë, duke e matur nga rrafshi i montimit të parakolpit.

- mbi vagon dhe shkallë;

1) 20 cm nga qendra e vagonit dhe shkallëve;

2) deri në lartësinë prej 2 m.




- Nga fundi i vagonit

3) Në maksimum 21 cm; dhe


4) Deri në lartësinë 2 metra referuar rrafshit të kokës së shinës; dhe

5) Deri në një maksimum prej 41 cm sipër kësaj lartësie.



- Përmbi ganxhën e vagonit

6) 20 cm në të dyja anët e çengelit dhe 20 cm sipër.




Neni 16

Vagonët e sigurimit të ngarkesës (vagon shtesë – sigurimi)

Këto lloje vagonësh duhet të përdoren kur ngarkesa tejkalon gjatësinë limit të saktësuar në neni 15/2. Distancat e mëposhtme të paraqitura duhet të respektohen:

1) – 35 cm midis ngarkesave;

2) – 10 cm midis ngarkesës dhe dyshemesë së vagonit të sigurimit të ngarkesës.



Distanca prej 10 cm nga dysHEMEJA duhet të respektohet kur ngarkesa del jashtë më tej aksit të fundit ose qendrës së karretës të vagonit të ngarkuar jo më tepër se 6.5 m.

Për ngarkesa me dalje të madhe zbatohen vlerat sipas tabelës së mëposhtme (janë bazë për kalkulime : profil I 100); vlerat e ndërmjetme duhet të përcaktohen ndërmjet interpolimit.

Tejkalimi deri	Hapësira nga dysHEMEJA
7.0 m	13.0 cm
8.0 m	16.0 cm
9.0 m	19.0 cm
10.0 m	23.0 cm

Neni 17

Çiftimet e përhershme, të shumëfishta ose vagonë të lidhur

1. Një vagon i përgatitur nga njësi të lidhura në mënyrë të përhershme ose një vagon i shumëfishtë është një grup prej disa vagonësh që funksionojnë si një vagon i vetëm. Një vagon i tillë mund të jetë i formuar nga vagonë me akse ose vagonë me karreta.

2. Një vagon i tillë është një mjet i përgatitur nga elemente të veçanta dhe të lidhura nga pajisje të ndërmjetme. Ai përmban së paku 3 akse ose 3 karreta.

3. Ky vagon duhet të konsiderohet si mjet i veçantë në kuptimin e shfrytëzimit. Ai ka një numër identifikimi, dokumentacionin e ngarkimit si një mjet i vetëm, ka një kapacitet ngarkimi të përgjithshëm.

4. Ngarkesa limit për çdo element të veçantë është e barabartë me totalin e kapacitetit ngarkues, i ndarë në numrin e elementeve që përbëjnë grupin. Në çdo element duhet të respektohen në mënyrë të njëjtë rregullat si një vagon i zakonshëm veçanërisht në këndshikimin e shpërndarjes së ngarkesës në drejtimin gjatësor e tërthor të vagonit (shih, gjithashtu, paragrafin 5.9).

5. Mallrat e ngurta janë subjekt ku duhet të aplikohen kushtet për shpërndarjen e ngarkesës në disa vagonë. Ngarkesa mund të jetë e shtrirë duke kaluar mbi zonën e lidhjes së vagonëve. Në këtë rast, duhet të merret parasysh toleranca e lëvizjes gjatësore (shih, gjithashtu, paragrafin 4.3).

Kushtet e sigurimit që zbatohen në vagonët shtesë mund të zbatohen për analogji dhe për ngarkesat që vendosen vetëm në një element dhe dalin jashtë vagonit duke kaluar mbi zonën e lidhjes.

KAPITULLI V

Neni 18

Metodat e ngarkimit dhe sigurimi

1. Parimet bazë

Lloji i mallit, karakteristikat e vagonit dhe linja në të cilën do të lëvizet, duhet të merren parasysh gjatë procesit të ngarkimit. Sigurimi teknik i lëvizjes nuk lejon kompromise si zhvendosje ose lëvizje të ngarkesës, ndryshim të qendrës së gravitetit, influenza të erës ose prezencë të dëborës ose akullit në sipërfaqen e ngarkimit ose në ngarkesë etj. Ngarkesa duhet të sigurohet që të ketë një pozicion të stabilizuar dhe të siguar për lëvizje gjatësore ose tërthore, rënie, lëvizje, rrotullim, anim dhe ngritje (nga era). Nuk duhet të shkaktohen dëmtime nga zgjedhja e pozicionit të ngarkesës dhe mënyra e fiksimit të mallit në vagon.

Vagonët pajisen me sponda, krahë dhe pajisje të tjera fiksime që duhet të përdoren për sigurimin e mallit. Spondat dhe krahët duhet përgjithësisht të jenë sipas kushteve teknike. Kur këto nuk sigurojnë stabilitetin e ngarkesës, p.sh., në rastet e ngarkesave jashtë dimensioneve, atëherë sigurimi i tij bëhet subjekt i një marrëveshje ndërmjet transportuesve hekurudhor duke përdorur pajisje të veçanta.


2. Mallra që ngarkohen rifuzo (pa ambalazhim)

Mallra, të tilla si: skrap i çelikut, ambalazhe letre të përdorura, lënde druri e sharruar, materiale ndërtimi (zhavorr, çakull), minerale etj., duhet të jenë të shpërndarë në të gjithë sipërfaqen e ngarkimit të vagonit.

3. Mallra të lehta (ose pjesë të tyre) me prirje për t'u larguar nga efekti i fryrjes së erës, të tillë si:


- lllamarina çeliku (pavarësisht nga formati, sipërfaqja dhe trashësia), pjesë skeletesh, përzierje me pjesë të lehta ose të rënda skrap;
- kartonë, dërrasa dhe pllaka druri 15 mm trashësi;
- ashkla druri;
- pako gazetash, grumbull letrash të vjetra etj.;
- ashklat e druri mund të ngarkohen në formë koni, malli duhet të mbulohet me gjithë gjatësinë e sipërfaqes (pavarësisht nga lartësia e mallit), siç është përshkruar në seksionin 6.

Duhet të ngarkohen me një lartësi jo më të madhe se lartësia e spondeve, në tërë aksin gjatësor të vagonit.



4. Mallrat e rënda, të cilat janë të prirur të bien nga vagoni, si rezultat i vibracioneve gjatë lëvizjes ose lëkundjeve në ndërruese, të tillë si:

- kartonë me trashësi më tepër se 15 mm;
- skrap i rëndë, si skrap me copa, pjesë të fonderisë, ashkla, materiale inerte etj., duhet të ngarkohen deri afërsisht 10 cm poshtë lartësisë së sfondit. Gjithashtu, duhet të pakëtohen ose si skrap i presuar ose si automjete të shtypura dhe duhet të ngarkohen deri në lartësinë e spondit.



Mallra të lehta ose të rënda të këtij lloji nuk duhet të dalin jashtë lartësisë së spondeve dhe as të shtohet lartësia e spondeve.

5. Mallra rifuzo (në trajtë pluhuri)

Mallra, të tilla si: minerale, qymyr guri, koks, rërë, fosfate, panxhar sheqeri etj., duhet të shpërndahen në të gjithë sipërfaqen e vagonit.


6. Mallra që ngarkohen në vagonë të zakonshëm ose special

A. Vagonë të zakonshëm

Ngarkimi në formë koni


1. Deri në një lartësi afërsisht 50 cm mbi sfondet.

2. Malli duhet të jetë në kontakt me spondet e vagonit deri në një lartësi 15 cm, poshtë lartësisë së spondit.



Ngarkimi pa formë koni


3. Malli ngarkohet deri në lartësinë e spondave të vagonit (këtu nënkuptojmë dhe lartësinë në mesin e vagonit).



B. Vagon special (i përshtatur për vetërrëshqitje të mallit ose shkarkim me gravitacion)

1. Hapësira e volumnit në këta vagonë duhet të mbushet në mënyrë uniforme në drejtim gjatësor dhe tërthor.

2. Nuk është e lejueshme që të ngarkohet nga njëra anë dhe të lihet bosh nga ana tjetër.




7. Mallra me prirje të zhvendosen nga era fosfati, rëra, koncentratet ose mallrat e trajtuara nga RID duhet të:

- ngarkohen në vagonë të mbyllur; ose
- të mbulohen me mushama (shih paragrafin 6).

8. Mallrat kompakte ose me formacion të ngurta (mallra të sarta, kompakte).

Këto mallrat nuk kanë prirje për lëvizje dhe janë të afta t'u qëndrojnë ndikimeve për lëvizje.

Ngarkesa e tyre bëhet sipas fig. 1 dhe 2.




Sigurimi i ngarkesës bëhet duke përdorur pajisjet që ka vagoni. Nëse vagoni ka pajisje të veçanta fiksimi, atëherë sigurimi i mallit bëhet si më poshtë:

9. Mallrat që sigurohen nëpërmjet pajisjeve ndarëse, spondave e krahëve.

Mallrat e ngarkuara, në drejtimin tërthor, duhet të jenë në kontakt me ndarëset, spondet e krahët¹.

1. Pjesët që përdoren për të siguruar ngarkesën, qoftë në drejtimin gjatësor ose tërthor në vagon duhet të kenë një lartësi të paktën 10 cm mbi lartësinë efektive të ngarkesës.

Njesite e ngarkesave që janë:



¹ Jo më tepër se 10 cm larg këtyre pjesëve të vagonit.

a) Të prirura që të anohen, duhet të sigurohen në një lartësi që e kalon qendrën e gravitetit nëpërmjet spondeve ose ndarëseve.


b) Të prirura që të vetërrotullohen dhe që janë në pjesën e sipërme të spondave ose pajisjeve ndarëse, duhet të jenë të siguruara në mënyrë të tillë që lartësia e spondeve ose pajisjeve ndarëse të paktën të jetë më e madhe se gjysma e diametrit të tyre. Lartësia efektive e spondeve e pajisjeve ndarëse duhet të jetë parashikuar më e madhe së paku 10 cm (shih skemën).

2. Kur ngarkesa është siguar duke përdorur vetëm dy krahë, malli mund të shtrihet në drejtimin gjatësor përtej qendrës për çdo krah të paktën:

50 cm	30 cm
ose në qoftë se sipërfaqja mbështetëse është e ashpër	ose në qoftë se sipërfaqja mbështetëse është e ashpër
30 cm	20 cm

3. Njësi stabël që janë si një objekt i vetëm, sigurohen si njësi më vete dhe vetëm nëpërmjet një krahu, ana tjetër sigurohet duke përdorur tako druri.

4. Stiva me seksion kënddrejtë prej dërrasash të sharruara ose arka, në qoftë se sigurohen nëpërmjet një krahu, dhe mendohet që është i pamjaftueshëm, bëhen lidhje suplementare duke i përshtatur sipas rastit.




10. Sigurimi i ngarkesave nëpërmjet plotësimit të hapësirave dhe përdorimi i takove mbështetëse.

1. Plotësimi i hapësirave boshe. Në këtë rast hapësirat boshe plotësohen p.sh., me paleta të rrafshëta (kënddrejta) ose me jastëkë ajri. Nëse hapësira për t'u plotësuar është e gjerë (e madhe), vendosen tako mbështetëse prej druri (të paktën dy tako në secilin drejtim) me një minimum seksioni tërthor të domosdoshëm prej 10 x 10 cm.


2. Numri i takove varet nga pesha ngarkesës dhe gjatësia e takos. Për një gjatësi prej 2 m dhe peshë ngarkese prej 10 tonë, p.sh. përcaktimi bëhet:

4 tako (10 x 10 cm)	2 tako (10 x 10 cm)
---------------------	---------------------



11. Sigurimi duke përdorur tako dërrase, pjesë drejtuese ose tako

1. Takot duhet të kenë të paktën 5 cm trashësi dhe pjesa mbështetëse vendoset te sipërfaqja e kontaktit kënddrejtë.



Lartësia efektive e takove duhet së paku të jetë:

2. - 5 cm për të parandaluar lëvizjet gjatësore;

3. - 3 cm për të parandaluar lëvizjet tërthore.

Aftësitë mbajtëse të takove të gozhdhuara limitohet nga pesha e ngarkesës si më poshtë:

- Përkundrejt lëvizjes gjatësore, limiti i përafërt

3 t | 12 t

- Përkundrejt lëvizjes tërthore, limiti i përafërt 30 tonë

Numri i gozhdëve të përdorura është të paktën 2 për tako. Zbatimi për tipa të ndryshëm mallrash merr parasysh:

- Peshën e ngarkesës që do të sigurohet;

- Forcat që ushtrohen;

- Nivelin real të fërkimit.


Në rast se përdoren gozhdë me diametër 5 mm dhe koeficient mesatar fërkimi ($\mu = 0.4$), njësia e ngarkesës mund të jetë e siguruar kur takot fiksohen si më poshtë:

a) Në drejtimin gjatësor të vagonit në të dyja fundet vendosen të paktën:

1 gozhdë për 100 kg | 1 gozhdë për 400 kg

b) Në drejtimin tërthor të vagonit në secilën anë të paktën 1 gozhdë për 1.500 kg.

Gozhdët duhet të jenë të drejtuara vertikalisht dhe të shpërndara në gjatësi në mënyrë të barabartë. Ato duhet të hyjnë të paktën 40 mm në thellësi të dyshemesë ose të dërrasave mbështetëse.



Numri i gozhdëve i përdorur për një pykë të dhënë është i kufizuar për të shmangur plasaritjen ose çarjen e drurit. Për një tako me një gjerësi deri në 10 cm, mund të përdoren jo më tepër se 3 gozhdë. Në qoftë se del e domosdoshme, tako duhet të sigurohet duke përdorur vidha druri dhe pllaka çeliku lidhëse.


Është, gjithashtu, e mundur, në drejtimin tërthor, të përdoren gozhdë me diametër të vogël, në qoftë se thellësia e ndikimit ose numri i gozhdëve në lidhje me masën e ngarkesës është gjykuar të merret si e tillë.

Gozhdët grover kanë rezistencë të lartë në heqje në krahasim me gozhdët e lëmuara. Në kuptimin e forcës së mbërthimit një gozhdë grover me diametër $d_n = 4.2$ mm është e krahasueshme me 1 gozhdë të lëmuar me diametër $d_n = 5$ mm.

Për sigurimin e mallrave në drejtimin tërthor në vagon, duhet referuar tabelës që vijon:

Tipi i gozhdës	Diametri i gozhdës d_n (mm)	Ndikimi minimal S (mm)	Masa e ngarkesës ngarkesë/gozhdë (t)
grover	4.2	40	1.5
lëmuar	5.0	40	.5
lëmuar	4.6	50	1.5
lëmuar	4.2	50	1.0

Distanca minimale midis gozhdëve duhet të respektohet dhe nga gozhdë te pjesa fundore e takos ose dërrasës. Kjo distancë varet nga drejtimi i forcës, nga kompaktësia e drurit të takos dhe nga diametri i gozhdës. Një tako (pykë) druri me dimension 12 cm lartësi x 8 cm gjerësi mundet të përdoret me 4 gozhdë me 5 cm diametër. Nëse numri i gozhdëve është më i madh, atëherë gjatësia e takos duhet të rritet.




12. Fiksime (lidhjet) direkte

Lidhjet direkte bëhen në drejtimet ku lindin forcat dhe kanë si detyrë t'u rezistojnë lëvizjes së ngarkesës.

Në varësi nga lloji i mallit, pesha e tij dhe metoda e përdorur e ngarkimit mund të jenë të përshtatshëm lidhja me zinxhir me hallka çeliku të rrumbullakët, litar çeliku, shirita (qafore) të thurura ose shirita të pathurur¹. Shiritat (rripat) prej çeliku nuk janë të lejueshme për arsye të rreziqeve të aksidenteve që mund të lindin nga thyerjet e tyre. Për mallra me peshë deri në 3 tonë, është, gjithashtu, e mundur të përdoren tela çeliku të kalitur.

1. Kur mallrat janë të siguar vetëm me lidhje direkte, lidhja duhet të bëhet në dy drejtimet gjatësore e tërthore në vagon. Në parim duhet të ketë dy lidhje në çdo drejtim.



Lidhja direkte me vendosje gjatësore në vagon mund të konsiderohet me parametra e duhur nëse rezistenca në këputje² (forca e shtrëngimit) e lidhjes në çdo drejtim është të paktën:

3.200 daN	1.000 daN
-----------	-----------

Telat e çelikut të kalitur duhet të kenë të paktën një diametër prej 4 mm. Çdo lidhje duhet parashikuar të paktën me:

4 tela	4 tela
--------	--------


Zinxhirët, litarët dhe shiritat e thurur mund të aplikohen të kombinuara në rastet e përdorimit të:

2. Mënyrës së integruar të lidhjes (shtrëngimit);

¹ Shirita të pathurur, duhet kuptuar ato që janë përgatitur nga tre gërsheta të thurur me fije poliesteri të cilësisë së lartë, plotësisht të mbështjellë me një shtresë potileri të cilësisë së lartë (kufiri i përdorimit 25-70 C).

² Rezistenca në këputje = me dy herë forca e lejueshme e tendosjes.


3. Mënyrës me lidhje të veçanta (pajisje) të shtrëngimit.




Llozat dhe tokëzat për sigurimin e shiritave (rripave) duhet të përshtaten sipas tipave të shiritave me kusht të një funksionaliteti të rregullt e të sigurt.

Lidhjet mund të jenë:

4. Shtrëngimi nëpërmjet nyjave (laqeve); ose
5. Shtrëngimi nëpërmjet ganxhave (grepa etj.) fikse.
6. Kur malli ka (qoshe) të mprehta, shiriti duhet të jetë i përfshirë në një manikot plastike (ose lëndë tjetër mbrojtëse), për të mos rrezikuar këputjen e shiritit.



7. Gjatë lidhjeve shtrënguese me tela çeliku, shiritat duhet të jenë të përdredhur (gërshetuar) në çift.




Numrat e mësipërm janë numrat e referuar në figura.

13. Mallra me mundësi lëvizje gjatësore në vagon.

Mundësia e rrëshqitjes mund të ekzistojë në vagonë individuale dhe në grup vagonët për:

1. Ngarkesa të rënda, të cilat nuk mund të sigurohen në mënyrë kompakte ose rregullim të fiksuar në drejtimin gjatësor të vagonit (të tilla si pako llamarinash çeliku).
2. Ngarkesa të cilat janë të ndjeshme nga ndryshimi i dinamikës së lëvizjes së vagonit (frenimet e forta etj.), me prirje për avari (dëme) si rezultat i forcave gjatësore që lindin gjatë lëvizjes (të tilla si makineri).




Për të parandaluar lëvizjen anësore të ngarkesës, gjë që të çon në prishjen (kapërcimin, shkeljen) e gabaritit të ngarkesës ose për të siguruar raportin 1: 1.25 midis qafave të akseve, ngarkesa duhet të sigurohet dhe nga ana anësore.

Dispozitat e nenit 19, pika 11 duhet të zbatohen gjithashtu.

14. Pajisjet slit

1. Trarët e pajisjes mbështetëse duhet të vendosen në drejtimin gjatësor të dyshemesë së vagonit. Pjesa e poshtme e anëve të tyre duhet të jenë me zmuso për të shmangur ndonjë vështirësi që mund të lindë nga mosrrafshmëria e sipërfaqes së dyshemesë së vagonit.

2. Pjesët përbërëse të pajisjeve mbështetëse duhet të jenë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme, duke përdorur pajisje lidhëse ose traversa tërthore. Fundet (pjesët anësore) të pajisjes mbështetëse duhet të lidhen me vidha të tejprtejme ose vida druri. Në pjesë të veçanta, si përjashtim, gozhdohen së bashku. Në këtë rast, përdoren vida druri dhe këto duhet të hyjnë në një thellësi të dërrasës së paku 40 mm.



Ngarkesa duhet të jetë e lidhur me pajisjen në mënyrë të tillë që të mos ketë mundësi lëvizjeje dhe që të mos ketë kontakt me dyshemën e vagonit.


Në qoftë se traversat tërthore përdoren me qëllimin e rritjes së sipërfaqes mbështetëse, ato duhet të lidhen me trarët lidhës të pajisjes mbështetëse.

Neni 19

Hapësirat (distancat)

1. Në drejtimin gjatësor në vagon, distancat duhet të zbatohen në të dyja anët:

- Të paktën 30 cm për mallra me sipërfaqe të papërpunuar (p.sh. blloqe guri).
- Të paktën 50 cm për mallra me sipërfaqe të sheshta (p.sh. tuba çeliku të grasatuara ose tuba me një shtresë boje ose prokate çeliku ose prodhime metalurgjike prej çeliku).
- 1.00 deri 1.50 m për mallra të ngarkuara dhe të mbështetura në tako, pajisje mbështetëse prej dërrase (p.sh., pako llamarinash çeliku, tambure kabllorësh, makineri).



2. Kufizimi i distancës së lëvizjes

Distanca e lëvizjes duhet të kufizohet nëse:

- Ka prirje të tejkalohet ngarkesa në aks;
- Ka prirje të tejkalohet raporti i lejuar të ngarkesës për aks ose për karretë;
- Ka prirje të dëmtohet malli ose vagoni;
- Malli ka prirje të cenojë distancat e kërkuara gjatë proceseve të manovrës.

Lëvizjet gjatësore mund të kufizohen sipas mënyrave të mëposhtme:

- Lidhjeve indirekte (p.sh. me shirita plastikë të gërshetuar);
 - Dërrasave (takove) ose materialeve të tjera me aftësi të ngritur (të mëdha) në fërkim;
 - Materiale elastike duke i përdorur si jastëkë në ballet e vagonit ose midis pajisjeve ndarëse.
- Këta tipa të sigurimit mund të përdoren individualisht ose të kombinuara.

Me disa raste, distanca e nevojshme nuk është kusht kur malli që do të transportohet nuk ka prirje për këtë lëvizje, p.sh., prodhime çeliku dhe shufra prej çeliku, fletë (llamarine) të mëdha e të mesme, llamarina çeliku të petëzuara, shufra çeliku të paratensionuara, lidhje tubash çeliku dhe shina të ngarkuara në vagon. Në pjesën më të madhe të rasteve, këto mallra janë mallra që nuk lëvizin e kërkojnë të gjithë gjatësinë e vagonit për ngarkim. Çdo mënyrë e përmendur më sipër për

sigurimin e tyre nuk është zgjidhje në vetvete. Ato mund të zbatohen sipas rastit me kosto të ndryshme. Në rastet kur ngarkesa ka lëvizur si rezultat i manovrave dhe prishen distancat që kërkohen nga personeli manovrist, atëherë kjo duhet të rregullohet sipas rastit konkret.

Neni 20 **Fiksimi indirekt**

Fiksimi indirekt rrit aderencën (sipërfaqen e kapjes) dhe përmirëson stabilitetin e njësive të ngarkesës.

1. Lidhjet që përdoren janë të preferueshme të jenë prej shiritave të thurur ose lidhëse sintetike. Ato duhet të përdoren në sistemin e integruar.

2. Çdo njësi ngarkese duhet të ketë të paktën 2 lidhje indirekte të zbatuara afërsisht 50 cm prej fundit të ngarkesave.


Rezistenca në këputje (forca tërheqëse e lidhjes)¹ varet nga pesha, gjatësia dhe sipërfaqja e mallit. Konkretisht:

- 1000 daN - 4.000 daN, me një shtrëngim fillestar të paktën 300 daN. Shiritat prej çeliku mundet të mos përdoren për arsye të rreziqeve të veçanta me aksidente nga këputjet e tyre.

Pajisjet, tokëzat dhe llozat duhet të përshtaten sipas tipit të shiritit, që ato të jenë funksionale dhe shtrëngimi të bëhet i efektshëm. Lidhja, për aq sa është e mundur, duhet të jetë e fiksuar duke përdorur çengelat dhe të tensionohet nëpërmjet laqeve (laqet dublojnë forcën e tërheqjes). Përdorimi i nyjave redukton rezistencën në këputje të lidhjeve afërsisht 60%. Reduktimi i rezistencës në këputje duhet të kompensohet me lidhje të fuqishme.

Kur ngarkesa është me anë (cepa) të mprehta, shiritat duhet të jenë të futur në një mbrojtëse ose e quajtur manikot mbrojtës.

Për mallra që kanë sipërfaqe të sheshtë (të lëmuar) duhet të përdoren zgjidhje të veçanta nëpërmjet rritjes së koeficientit të fërkimit përveç lidhjeve.



Neni 21 **Rritja e koeficientit të fërkimit midis mallrave dhe dyshemesë**

Rritja e koeficientit të fërkimit duhet të arrijë në nivelin të paktën $\mu = 0.7$. Kjo kërkohet në rastet e mëposhtme:

- Për të zvogëluar lëvizjet gjatësore në vagonë, si p.sh. për:
 - mallra me sipërfaqe të veshura, të lëmuara ose tuba çeliku të grastuar;
 - pllaka guri të lëmuara;
 - mallra të paletizuar që ngarkohen me sipërfaqe të lëmuara;
 - tambure letre të ngarkuara vertikalisht ose horizontalisht;
 - panele tallashi të presuara.
- Për të zvogëluar lëvizjet anësore, si p.sh. për:
 - rula letre të ngarkuara shtrirë ose drejt;
 - bobina çeliku të petëzuara të ngarkuara shtrirë;
 - panele tallashi të presuara.

Elementet që influencojnë në rritjen e koeficientit të fërkimit nuk sigurojnë ngarkesën që ajo

¹ Rezistenca në këputje = dy herë forca e lejueshme e tendosjes.

të mos bjerë nga vagoni dhe që ajo të mos cenojë gabaritin. Ky funksion kryhet nëpërmjet pajisjeve ndarëse, spondave dhe krahëve.

Neni 22

Mallra me prirje rrotullimi

Mallra të tilla si rulonat e letrave, tamburet e kablllove, çiftet e rrotave hekurudhore, njësi ngarkesash të tjera cilindrike, automjete etj., duhet të sigurohen nga vetërrrotullimi në të gjitha drejtimet, duke i fiksuar nëpërmjet pajisjeve ndarëse, spondeve, krahëve, takove, pajisjeve mbështetëse ose slitave.

Neni 23

Vendosja në aksin gjatësor të vagonit

- Mallrat me një peshë individuale deri në 7 tonë (objekte individuale të ngarkuar krah për krah ose njëri pas tjetrit) mundet që të mos qëndrojnë direkt në dyshtemenë e vagonit, prandaj ato duhet të jenë të siguruar me tako.

- Mallrat me një peshë individuale deri 10 tonë duhet të ngarkohen në pajisje mbështetëse. Në qoftë se pajisja mbështetëse ka konstruksion druri, ajo duhet të fiksohet në dyshteme.

- Mallra me një peshë individuale që tejkalon 10 tonë mund të ngarkohet në vagon ose kontejner duke i përshtatur një pajisje slit.

A. Ngarkesa individuale ose në grup me peshë deri në 7 tonë

Këto ngarkesa mund sigurohen duke përdorur tako si më poshtë:

1. Tako me kënd afërsisht 35° për mallra deri 45° për mjete;
2. Tako me lartësi $1/8$ e diametrit, por jo më të vogël se 12 cm;
3. Tako me gjerësi të paktën $2/3$ e lartësisë së takos.

Mallrat duhet të sigurohen në të gjitha drejtimet nga rrotullimi duke përdorur:

4. Të paktën dy tako ose
5. 1 tako afërsisht $3/4$ e gjatësisë së ngarkesës.

Në drejtimin tërthor në vagon, malli duhet siguruar duke përdorur

6. Dërrasa afërsisht 30 cm të gjata e të paktën 5 cm lartësi; ose

- pajisje mekanike; ose

- pjesë me fërkim të rritur (material kauçuku) për mallra individuale me peshë deri afërsisht 2 tonë (koeficienti i fërkimit të paktën 0.7μ).

Dërrasat duhet të fiksohen duke përdorur gozhdë me diametër afërsisht 5 mm.

- Në çdo drejtim të rrotullimit me një total prej


1 gozhdë për 500 kg | 1 gozhdë për 2,000 kg

- Në drejtim tërthor në vagon, përdoret 1 gozhdë për 1500 kg mall.

Gozhdë, kudo që mundet, duhet të vendoset vertikalisht dhe të penetrojë në thellësi të paktën 40 mm. Ato duhet të jenë shpërndarë në mënyrë të barabartë në takot ose dërrasat, por të paktën 2 gozhdë për tako ose dërrase. Duhet të përdoren jo më tepër se 3 gozhdë për tako me gjerësi deri 10 cm.

Mallrat duhet të sigurohen përkundrejt animit.

- Kur gjerësia e mallit është më e vogël se $5/10$ e diametrit të tyre (në vagonët e sheshtë, me pak se $7/10$), p.sh., gjatë fiksimit të mallrave (shih 1.5).



B. Mallra individuale me peshë deri 10 tonë

Çdo njësi duhet sigurohet me dy pengesa të përgatitura nga tako druri duke formuar një mbështetëse (slit) të lidhura me shirita llamarine çeliku.

1. Gjerësia e ngarkesës duhet të jetë të paktën 5/10 e diametrit të tij (7/10 në vagonët platformë).

2. Ngarkesa nuk duhet të jetë në kontakt me dyshemenë, as të ketë prirje të lëvizë nga pengesat (slita).


3. Këndet e takove në lidhje me mallin duhet të jenë afërsisht 35° dhe deri në 45° për automjetet.

4. Lartësia e takove duhet të jetë sa 1/8 e diametrit, por jo më pak se 20 cm.

5. Gjerësia e takove: 2/3 e lartësisë së takove, por jo më pak se 15 cm.

6. Çdo dërrasë e takove duhet të jetë e veshur në 3 anët me shirit llamarine me të paktën 4 mm trashësi dhe të fiksohet me vida në vend.

7. Baza e shiritave duhet të jetë e mbrojtur nga lëvizja duke e fiksuar atë me të paktën 6 thumba (2x3), 10 deri 15 cm të gjatë.



C. Mallra individuale me peshë mbi 10 tonë

Këto njësi duhet të ngarkohen në vagonë ose kontejner të përshtatur me pajisjen mbështetëse.

1. Malli nuk duhet të qëndrojë në dysheme, por në pajisjen mbështetëse dhe as të ketë prirje të lëvizë përkundrejt pajisjes mbështetëse.

2. Lartësia efektive duhet të jetë të paktën 1/8 e diametrit.

3. Në drejtimin tërthor të vagonit, malli duhet të jetë i siguar përkundrejt lëvizjes dhe i mbështetur në nivelin e qendrës së tij të gravitetit për ta parandaluar nga animi, nëse gjerësia është më pak se 4/10 e diametrit të tij.

Neni 24

2. Pllakat ngarkohen në stiva, njëra mbi tjetrën me hapësirë mes tyre, ngarkesa bëhet direkt në dyshtemenë e vagonit, në traversa bylykose binar druri dhe me binar të ndërmjetëm.


Binarët e drurit dhe binarët e ndërmjetëm prej druri duhet:

- Të kenë seksion katërkëndësh dhe të vendosen nga ana e faqes së gjerë;
- Të radhiten vertikalisht njëri mbi tjetrin;
- Të pozicionohen direkt përkundrejt vendit të lidhjes; dhe
- Të jenë të gjatë afërsisht sa është gjerësia e ngarkesës, por jo më e gjatë se gjerësia e mallit.

Pllakat më të trasha duhet të vendosen në pjesën e poshtme të stivës dhe ngarkesat duhet të shpërndahen për sa është e mundur në sipërfaqen e vagonit.

3. Lartësia e stivës nuk duhet të tejkalojë lartësinë e spondave.

4. Nuk kërkohet që të ketë hapësirë (distancë) midis stivës dhe balleve të vagonit.



Sigurimi

- Në drejtimin gjatësor të vagonit.

5. Nëpërmjet spondave ballore

- Në drejtimin tërthor të vagonit.

6. Nëpërmjet lidhjeve të bëra me litar çeliku i gërshetuar prej 4 fije teli (5 mm).

Lidhjet duhet të kalojnë sipër ngarkesës, tejpertej në unazat e vagonit ose në pajisjet e tjera të kësaj natyre që ndodhen në konstruksionin e vagonit në të dyja anët dhe përqafojnë gjithë ngarkesën dhe dublohet në të dyja anët. Pjesët anësore të ngarkesës sigurohen nëpërmjet 8 lidhjeve me litar çeliku të gërshetuar.

7. Çdo pllakë duhet të mbahet e shtrënguar, nëpërmjet të paktën 2 lidhjeve. Pllakat mund të dalin në drejtimin gjatësor jashtë vendit të lidhjes së paku 50 cm.

8. Lidhjet duhet të bëhen afërsisht çdo 3 m.

Të dhëna shtesë:

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës (shih nenin 2 dhe 3).

Neni 13

Bobina llamarine çeliku (të grasatuara ose të pagrasatuara)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonët me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Bobinat e llamarinave, me një peshë maksimale (individuale ose në grup) prej 7 tonë ngarkohen horizontalisht.

1. Çdo bobinë është e lidhur dy herë përreth perimetrit.

2. Bobinat me metal të grasatuar duhet edhe të jenë të lidhura tri herë përkundrejt aksit gjatësor (shih fig.).

3. Mundet të lidhen disa bobina së bashku me 4 lidhje të veçanta.

Tipi i lidhjes: me shirita çeliku, me forcë këputëse të paktën 14 kN për lidhjen e bobinave individuale e të paktën 20 kN për lidhjen së bashku të disa bobinave.

Vagonët

Vagonë me sponda ballor ose sponda anësore dhe dysHEME druri (K..., Li..., Re..., H..., Si..., T...).

Metoda e ngarkimit


4. Bobinat e llamarinave ngarkohen mbi dysHEMENË e vagonit ose në pajisje me konstruksion druri vendosur në drejtimin gjatësor të vagonit (seksion tërthor i binareve është afërsisht 5 x 12 cm), binarët vendosen në dysHEMENË e vagonit nga ana e sipërfaqes më të madhe.

5. Ngarkohen në mënyrë individuale, nëse gjerësia e tyre është të paktën 5/10 e diametrit.

6. Ngarkohen të lidhura kokë për kokë si një njësi, nëse gjerësia e secilës bobinë është të paktën 1/3 e diametrit dhe nëse gjerësia e përgjithshme e secilës njësi është të paktën 7/10 e diametrit.

7. Ngarkohen në grup, njëra mbas tjetrës (të takuara); për ngarkesat që kalojnë 7 tonë, formohen grupe të vogla.

8. Hapësira me spondin ballor: të paktën 50 cm.



Sigurimi

9. Në drejtimin gjatësor të vagonit, secila bobinë, si dhe njësitë e formuara nga disa bobina duhet të sigurohen me të paktën 2 tako në çdo anë dhe drejtim lëvizjeje.

10. Në grup (maksimumi 7 tonë) siç tregohet në figurë.

Dimensionet e takove: lartësia minimale 12 cm, gjerësia minimale 12 cm, këndi i pjerrësisë afërsisht 35° . Numri i gozhdëve për tako për secilën anë (në total).

1 gozhdë/500 kg ngarkese

1 gozhdë/2.000 kg ngarkese

11. Në drejtimin tërthor të vagonit, secila bobinë duhet të sigurohet me tako bllokimi me të paktën 5 cm trashësi dhe të paktën 3 cm lartësi efektive.

Numri i gozhdëve në tako në secilën anë (totali): 1 gozhdë/1.500 kg, por të paktën përdoren 2 gozhdë për tako.

Të dhëna shtesë:

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 14

Bobina llamarine të pagrasatuara të fabrikuara me nxehtësi

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonët me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

1. Bobinat e llamarinave, ngarkohen me sistemin vertikal (vështtrim nga qielli) në dyshtemenë e vagonit (diametri minimal 7/10 të H) ose pajisje druri (diametri minimal = H).

2. Bobinat e llamarinave lidhen me shirit çeliku (forca e këputjes të paktën 15 kN) të paktën:

- Dy herë përkundrejt perimetrit;

- Një herë përkundrejt perimetrit dhe një herë përkundrejt aksit gjatësor;

- Tri herë përkundrejt aksit gjatësor.

Vagonët

Vagonët me dyshteme dërrase (K..., L..., R..., Sa..., Si...)

Metoda e ngarkimit


Bobinat e llamarinave ngarkohen:

3. Direkt në dyshtemenë e vagonit.

4. Në dy pajisje druri gjatësore, të vendosura paralel (seksioni tërthor afërsisht 5 x 12cm), të shtrira në faqen më të madhe. Distanca midis dërrasave duhet të jetë të paktën 7/10 e diametrit të bobinës.

5. Ato duhet të dalin të paktën 30 cm përtej bobinës llamarinës në të dyja anët.

6. Distanca (hapësira) minimale : 50 cm.



Sigurimi¹

Nuk kërkohet masa suplementare

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës shih nenin 2.

Neni 15

Tuba çeliku me rreshta, diametri më i madh se 65 cm (26")

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar Vagonët me amortizator me kors të gjatë
--------------------------------------	--

Tipi i mallit

Tuba çeliku, me konfiguracion sipërfaqe të ndryshëm (me ose pa flanxha)

Vagonët

Vagonë me krahë dhe dysHEME dërrase (K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

1. Tubat ngarkohen direkt në dysHEMENË e vagonit, në traversa (të lëvizshme) ose në dërrasa:

Në një ose disa rreshta, kur është e mundur në të gjithë gjerësinë e vagonit, të rreshtuara vertikalisht.

2. Numri i rreshtave nuk duhet të jetë më i madh se numri i tubave për rresht (me maksimumi një rresht sipër të vendoset në formë bishtdallëndysheje).

3. Flanxhat ose fundet e gomuara nuk duhet të jenë në kontakt (tubot ngarkohen në mënyrë të alternuar).

4. Tubat dalin jashtë dërrasave ose traversave bylyk të paktën 50 cm.

5. Distanca (hapësira) minimale

- Për tubat e papërpunuar	30 cm	0 cm
- Për tuba të grasatuar ose të veshur të lëmuar	50 cm	0 cm

6. Dërrasat e mbështetjes dhe traversat bylyk duhet të jenë prej druri të shëndoshë, të padëmtuara dhe të sharruara prej një pjese, të shtrira përgjatë faqes së gjerë dhe të mos jetë në kontakt me krahët.

- Me një seksion tërthor të paktën 90 cm² dhe një minimum trashësi prej 6 cm.

- Seksioni tërthor total për rreshta (cm²) minimumi


- Për një masë të tubave për rresht (në tonë) maksimumi

7. Numri i dërrasave dhe takove anësore.

- Të paktën 2 për tub me gjatësi të paktën ose të barabartë me 12 m dhe masa deri 15 tonë për rresht;

- 4 (në dy çifte) për tub me gjatësi më të madhe se 12 m dhe masë më të madhe se 15 tonë për rresht;

- Dërrasat fiksohen me të paktën 4 gozhdë (diametër 5 mm, thellësia penetrimit të paktën 40 mm).



¹ Në hekurudhat CFF/SBB dhe GC(SJ) malli sigurohet në drejtimin anësor me pajisje drejtuese.

Sigurimi

8. Të gjithë krahët duhet të jenë të ngritura.

9. Secili rresht i tubave duhet të sigurohet me tako.

- Takot fiksohen te dërrasat ballë për ballë, sipër dhe poshtë;

- Takot duhet të kenë të njëjtën gjerësi si dërrasat dhe dërrasat tërthore;

- Lartësia e takove duhet të jetë sa $\frac{1}{2}$ e diametrit të tubave, por jo më të vogla se 12 cm, këndi i takove afërsisht 35° ;

- Takot duhet të jenë të siguruara në dy anët e ngarkesës.

10. Midis krahëve

- Me gozhdë;

- Numri i gozhdëve (diametri 5 mm) në secilën anë: totali 1 për 1500 kg ngarkesë (kjo që rreshti të jetë i siguruar, përfshirë kur ka dhe rreshta sipër në formë bishtdallëndysheje), gozhdët duhet të shpërndahen në mënyrë uniforme, që duhet të jenë të paktën 4 për çdo tako (dy nga ana e brendshme dhe dy nga ana e jashtme), duhet të ngelen vertikalisht dhe të penetrojnë në një thellësi afërsisht 40 mm.

11. Sipër krahëve (tuba të cilët dalin mbi lartësinë e krahëve më tepër se gjysma e diametrit të tyre) si në pikën 10 dhe me pllakë lidhëse çeliku me 3 mm trashësi e lidhur me dërrasën në të dyja anët me vida druri; numri i vidave të drurit duhet të jetë të paktën për diametër 6 mm të vidave dhe gjatësi të pllakës lidhëse 6 mm, për çdopllake: 9 (3 në çdo tako dhe 3 në dërrasë) shih figurën.

12. Për tuba të grasatuar ose të veshur të lëmua: përdoren materiale me koeficient të lartë fërkimi (μ të paktën 0.7).

13. I rreshtave të tubave të ngarkuar në sistem bishtdallëndysheje bëhet duke i lidhur me rreshtin mbështetës të poshtëm me të paktën 2 shirita (forca këputëse minimale 40 kN) të tërhequra me pajisje të përshtatshme.

14. Stivat e tubave lidhen poshtë me shirita të tërhequr me pajisje (forca këputëse të paktën 40 kN) një shirit për çdo 7 m gjatësi tubash dhe të paktën 2 shirita për stivë (shiriti vendoset afërsisht 50 cm larg nga fundi i tubave), duke pasur parasysh dhe kushtet në vijim:

- Kur tubat dalin mbi krahët më tepër se gjysma e diametrit të tyre ose
- Kur distanca është më e vogël se ajo e theksuar në pikën 5 ose
- Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar

- Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar dhe në mungesë të pajisjeve me koeficient fërkimi të lartë

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Për trafik të destinuar për RENFE, shiritat (fiksime indirekte) duhet të jenë të tensionuar me pajisjen përkatëse.

Tuba çeliku me rreshta, diametri mbi 40 cm deri 65 cm (16~26~)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Vagonët me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Tuba çeliku me konfiguracion sipërfaqësor të ndryshëm (me ose pa flanxha)

Vagonët

Vagonë me krahe dhe dysHEME druri (K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

Tubat ngarkohen direkt në dysHEMENË e vagonit, në traversa bylyk ose në dërrasa:

1. Në një ose shumë rreshta, kur është e mundur në gjithë gjerësinë e vagonit, të rreshtuara vertikalisht.

2. Numri i rreshtave nuk duhet të jetë më i madh se numri i tubave për rreshta (me maksimumi një rresht sipër të vendosur në formë bishtdallëndysheje).

3. Flanxhat ose fundet e sagomuara nuk duhet të jenë në kontakt (tubat ngarkohen në mënyrë të alternuar).

4. Tubat dalin jashtë dërrasave ose traversave bylyk të paktën 50 cm.

5. Distanca (hapësira) minimale

- Për tuba të papërpunuar 30 cm | 0 cm

- Për tuba të grasatuar ose të veshura të lëmuara 50 cm | 0 cm

6. Dërrasat e mbështetjes dhe traversat bylyk duhet të jenë prej druri të shëndoshë, të padëmtuar dhe përgatitura prej një pjese, të shtrira përgjatë faqes së gjerë dhe të mos jenë në kontakt me krahët.

- Me një seksion tërthor të paktën 80 cm² dhe një minimum trashësi prej 6 cm

- Seksioni tërthor total për rresht (cm²) minimumi 240 360 480


për një masë të tubave për rresht (tonë) maksimumi 10 15 20

7. Numri i dërrasave dhe takove anësore

- Të paktën 2 për tub me gjatësi të paktën ose të barabartë me 12 m dhe mase prej deri 15 tonë për rresht;

- 4 (në dy çifte) për tuba me gjatësi më të madhe se 12 m dhe masë më të madhe se 15 tonë për rresht;

- Dërrasat fiksohen me të paktën 4 gozhdë (diametri 5 mm, thellësia e penetrimit të paktën 40 mm).



Sigurimi

8. Të gjithë krahët duhet të jenë të ngritura.

9. Secili rresht i tubove duhet të sigurohet me tako siç tregohet në figurë (pa hapësirë).

- Takot fiksohen te dërrasat ballë për ballë sipër e poshtë;

- Takot duhet të kenë të njëjtin gjerësi si dërrasat dhe dërrasat tërthore;

- Lartësia e takove duhet të jetë sa $1/12$ e diametrit të tubave, por jo më e vogël se 12 cm;

këndi i takove;

- Afërsisht 35° ;

- Takot duhet të jenë të siguruara në dy anët e ngarkesës.

10. Midis krahëve

Me gozhdë

Numri i gozhdëve (diametrik 5 mm) në secilën anë, totali 1 për 1500 kg ngarkesë (kjo që rreshti të jetë i siguruar, përfshirë kur ka dhe rreshta sipër në formë bishtdallëndysheje); gozhdët duhet të shpërndahen në mënyrë uniforme, që të jenë të paktën 4 për çdo tako (dy nga ana e brendshme dhe dy nga ana e jashtme), duhet të ngulen vertikalisht dhe të penetrojnë në një thellësi afërsisht 40 mm.

11. Sipër krahëve (tuba të cilët dalin mbi lartësinë e krahëve më tepër se gjysma e diametrit të tyre) si në pikën 10 dhe me pllakë lidhëse çeliku me 3 mm trashësi e lidhur me dërrasa në të dyja anët me vida druri, numri i vidave të drurit duhet të jetë të paktën, për diametër 6 mm të vidave dhe gjatësi të pllakës lidhëse 60 mm, për çdo pllakë: 9 (3 në çdo tako dhe 3 në dërrasë), shih figurën.

12. Për tubat e grasatuara ose të veshur të lëmuar përdoren materiale me koeficient të lartë fërkimi (μ të paktën 0.7).

13. Rreshti i tubave i ngarkuar me sistem bishtdallëndysheje duhet të lidhet me rreshtin mbështetës të poshtëm me të paktën dy shirita (forca këputëse minimale 40 kN) të tërhequra me pajisje të përshtatshme.

14. Stivat e tubave lidhen poshtë me shirita të tërhequr me pajisje (forca këputëse të paktën 40 kN), 1 shirit për çdo 6 m gjatësi tubash dhe të paktën dy shirita për stivë (shiriti vendoset afërsisht 50 cm larg nga fundi i tubave), duke pasur parasysh dhe kushtet në vijim:

- Kur tubat dalin mbi krahët më tepër se gjysma e diametrit të tyre ose
- Kur distanca është më e vogël se ajo e theksuar në pikën 5 ose
- Kur tubat janë të grasatuara ose me veshje të lëmuar

- Kur tubat janë të grasatuara ose me veshje të lëmuar dhe në mungesë të pajisjeve me koeficient fërkimi të lartë

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Për trafik të destinuar për RENFE, shiritat (fiksimi indirekt) duhet të jenë të tensionuar me pajisjen përkatëse.

Tuba çeliku me rreshta, diametri mbi 25 cm deri 40 cm (10~16~)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Vagonët me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Tuba çeliku me konfiguracion sipërfaqësor të ndryshëm (me ose pa flanxha)

Vagonët

Vagonë me krahe dhe dysHEME druri (K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

Tubat ngarkohen direkt në dysHEMENË e vagonit, në traversa bylyk ose në dërrasa:

1. Në një ose shumë rreshta, kur është e mundur në gjithë gjerësinë e vagonit, të rreshtuara vertikalisht; dhe

2. Numri i rreshtave nuk duhet të jetë më i madh se numri i tubave për rreshta (me maksimumi një rresht sipër të vendosur në formë bishtdallëndysheje).

3. Flanxhat ose fundet e sagomuara nuk duhet të jetë në kontakt (tubat ngarkohen në mënyrë të alternuar).

4. Tubat dali jashtë dërrasave ose traversave biliko të paktën 50 cm.

5. Distanca (hapësira) minimale

- Për tuba të papërpunuar 30 cm | 0 cm

- Për tuba të grasatuar ose të veshura të lëmuara 50 cm | 0 cm

6. Dërrasat e mbështetjes dhe traversat bylyk duhet të jenë prej druri të shëndoshë, të padëmtuar, të sharruara prej një pjese, të shtrira përgjatë faqes së gjerë dhe të mos jenë në kontakt me krahët.

- Me një seksion tërthor të paktën 70 cm² dhe një minimum trashësi prej 5 cm.

- Seksioni tërthor total për rresht (cm²) minimumi 180 210 240


- Për një masë të tubave për rresht (tonë) maksimum 9 12 15

7. Numri i dërrasave dhe takove anësore

- Të paktën 2 për tub me gjatësi të paktën ose të barabartë me 12 m dhe masë prej deri 15 tonë për rresht;

- 4 (në dy çifte) për tuba me gjatësi më të madhe se 12 m dhe masë më të madhe se 15 tonë për rresht;

- Dërrasat fiksohen me të paktën 4 gozhdë (diametri 5 mm, thellësia e penetrimit të paktën 40 mm).



Sigurimi

8. Të gjithë krahët duhet të jenë të ngritura.

9. Secili rresht i tubove duhet të sigurohet me tako siç tregohet në figurë (pa hapësirë).

- Takot fiksohen te dërrasat ballë për ballë sipër e poshtë;

- Takot duhet të kenë të njëjtin gjerësi si dërrasat dhe dërrasat tërthore;

- Lartësia e takove duhet të jetë sa $1/12$ e diametrit të tubave, por jo më e vogël se 12 cm;

këndi i takove;

- Afërsisht 35° ;

- Takot duhet të jenë të siguruara në dy anët e ngarkesës.

10. Midis krahëve

Me gozhdë

Numri i gozhdëve (diametri 5 mm) në secilën anë, totali 1 për 1500 kg ngarkesë (kjo që rreshti të jetë i siguar, përfshirë kur ka dhe rreshta sipër në formë bishtdallëndysheje); gozhdët duhet të shpërndahen në mënyrë uniforme, që të jenë të paktën 4 për çdo tako (dy nga ana e brendshme dhe dy nga ana e jashtme), duhet të ngulen vertikalisht dhe të penetrojnë në një thellësi afërsisht 40 mm.

11. Sipër krahëve (tuba të cilët dalin mbi lartësinë e krahëve më tepër se gjysma e diametrit të tyre) me pllakë lidhëse çeliku si në pikën 10, pllaka me llamarinë 3 mm e lidhur me dërrasa në të dyja anët me vida druri, numri i vidave të drurit duhet të jetë të paktën, për diametër 6 mm të vidave dhe gjatësi të pllakës lidhëse 60 mm, për çdo pllakë: 9 (3 në çdo tako dhe 3 në dërrasë); ose

12. Gozhdë si në pikën 10 dhe kur tubat që tejkalojnë lartësinë lidhen në grup me rreshtin që është nën lartësinë e krahut nëpërmjet fashetave ose shiritave (forca këputëse të paktën 30 kN); numri i lidhjeve; 1 për çdo 6 m gjatësi tubash, por të paktën në total 2 lidhje për stivë.

13. Rreshtit të tubave i ngarkuar me sistem bishtdallëndysheje, bëhet duke e lidhur me rreshtin mbështetës të poshtëm.

14. Stivat e tubave lidhen poshtë me shirita të tërhequr me pajisje (forca këputëse të paktën 40 kN), 1 shirit për çdo 6 m gjatësi tubash dhe të paktën dy shirita për stivë (shiriti vendoset afërsisht 50 cm larg nga fundi i tubave), duke pasur parasysh dhe kushtet në vijim:

- Kur tubat dalin mbi krahët më tepër se gjysma e diametrit të tyre ose

- Kur distanca është më e vogël se ajo e theksuar në pikën 5 ose

- Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar

- Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar dhe në mungesë të pajisjeve me koeficient fërkimi të lartë

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Për trafik të destinuar për RENFE, shiritat (fiksimi indirekt) duhet të jenë të tensionuar me pajisjen përkatëse.

Neni 18

Tuba çeliku në rreshta bishtdallëndysheje, të mbështetura te krahët

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Tuba çeliku me sipërfaqe të çfarëdoshme

Vagonët

Vagonë me krahë dhe dyscheme druri (K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

Tubat ngarkohen të sistemuar si më poshtë:

1. Rreshti i parë vendoset direkt në dyshtemenë e vagonit, në traversa bylyk ose në dërrasa, të puthitura me njëra-tjetrën në gjithë gjerësinë e vagonit (pa hapësira).

2. Rreshti mbi të parin, ngarkohet në formë bishtdallëndysheje, tubat e këtij rreshti duhet të jenë me diametër të barabartë ose më të vogël se diametri i tubave të rreshtit mbi të cilën mbështeten, ngarkesa mbi krahët bëhet sa $1/3$ e gjerësisë së ngarkesës (afërsisht 90 cm).

3. Kur tubat dalin jashtë dërrasave të paktën 50 cm.


4. Dërrasat duhet të jenë nga dru i shëndoshë dhe të padëmtuara me seksion tërthor katërkëndësh, të shtrira përgjatë faqes së gjerë dhe mos të jenë në kontakt me krahët.

5. Distanca (hapësira) minimale

- për tuba të patrajtuara sipërfaqe të papërpunuar	30 cm	0 cm
- për tuba të grasatuar ose të veshura të lëmuara	50 cm	0 cm

6. Kur tubat janë ngarkuar mbi lartësinë e krahëve:

- krahët duhet të lidhen me tel dyfish me diametër 4 mm ose me shirit (forca këputjes minimale 10 kN) te pjesa e sipërme në rastin e krahëve të rrotullueshëm; ose
- krahët e rrotullueshëm duhet të fiksohen me tako.



Sigurimi

7. Të gjitha krahët duhet të jenë të ngritura

(tubat që mbështeten përkundërt krahëve, konsiderohet si mbështetje e rregullt kur lartësia e krahut kalon të paktën $\frac{1}{2}$ e diametrit të tubit).

8. Tubat që sigurohen nëpërmjet vetëm dy krahëve duhet të dalin përtej krahëve të paktën:

- për tuba me sipërfaqe të papërpunuar	30 cm	0 cm
- për tuba të grasatuar ose të veshur të lëmuar	50 cm	0 cm

9. I tubave të grasatuar ose të veshur të lëmuar:

përdoren pajisje me koeficient të lartë fërkimi (μ të paktën 0.70).

10. I stivave bëhet duke i lidhur nga poshtë me shirita ose fasheta (forca këputëse të paktën 30 kN), 1 për çdo 6 m të gjatësisë së tubave dhe të paktën 2 shirita për stivë; shiriti vendoset afërsisht 50 cm larg nga fundi i tubave, duke pasur parasysh dhe kushtet në vijim:

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Kur tubat dalin mbi krahët më tepër se gjysma e diametrit të tyre, ose - Kur distanca është më e vogël se ajo e theksuar në pikën 5 ose - Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar | <ul style="list-style-type: none"> - Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar dhe në mungesë të pajisjeve me koeficient fërkimi të lartë |
|---|--|

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e mallit dhe gabariti i ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Për trafik të destinuar për RENFE, shiritat (fiksimi indirekt) duhet të sigurohen tensionim i integruar nëpërmjet pajisjeve

Tuba çeliku të ngarkuar në stivë bishtdallëndysheje, me tako anësore

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonë me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Tuba çeliku me sipërfaqe të çfarëdoshme

Vagonët

Vagonë me krahë dhe dysHEME dërrase (K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

Tubat ngarkohen, të sistemuara si më poshtë:

1. Rreshti i parë vendoset direkt në dyshemënë e vagonit, në traversa bylyk ose në dërrasa, të puthitura me njëra-tjetrën.

2. Maksimumi 3 rreshta tip bishtdallëndysheje (gjithsej 4 duke përfshirë rreshtin e parë).

Diametri i tubave të rreshtit bishtdallëndysheje duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se diametri i tubave të rreshtit mbi të cilën mbështeten (ngarkohen).

3. Tubat dalin jashtë dërrasave të paktën 50 cm.

4. Distanca (hapësira) minimale


- për tuba me sipërfaqe të papërpunuar	30 cm	0 cm
- për tuba të grasatuar ose të veshura të lëmuara	50 cm	0 cm

5. Dërrasat duhet të jenë nga dru i shëndoshë dhe të padëmtuar, të klasit të lartë, të sharruara me seksion tërthor katërkëndësh të shtrira përgjatë faqes së gjerë dhe të mos jetë në kontakt me krahët; me të paktën 6 cm trashësi dhe e fiksuar me 4 gozhdë (diametri 5 mm, thellësia e penetrimit të paktën 40 mm).

6. Numri i takove i përshtatur me dërrasën:

- 2 tako për tuba me gjatësi deri 12 m dhe peshë 15 tonë për rresht;

- 4 tako (në dy çifte) për tuba me gjatësi mbi 12 m dhe peshë mbi 15 tonë për rresht.



Sigurimi

7. Të gjitha krahët duhet të jenë të ngritur.

8. Secili rresht i tubave duhet të sigurohet me tako siç tregohet në figurë (pa hapësirë).

- Takot duhet të kenë të njëjtën gjerësi si dërrasat dhe dërrasat tërthore;

- Lartësia e takos 1/12 e diametrit të tubit, por të paktën 12 cm, këndi i takos afërsisht 35°;

- Takot duhet të jenë të siguruara në të dyja anët e ngarkesës.

9. Në stivat ku nuk duhet të tejkalohet lartësia e krahut më tepër se gjysma e diametrit të tubit:

- Me gozhdë;

- Numri i gozhdëve (diametri 5 mm) në secilën anë: totali, 1 për 1500 kg ngarkesë (llogaritet në lidhje me totalin e masës së ngarkesës); gozhdët duhet të shpërndahen në mënyrë uniforme, me të paktën 4 gozhdë për tako (dy nga ana e brendshme dhe dy nga ana e jashtme), duhet të ngulen vertikalisht dhe të penetrojnë në një thellësi të paktën 40 mm.

10. Në stivat ku tejkalohet lartësia e krahut më tepër se gjysma e diametrit të tubit me gozhdë dhe pllaka lidhëse çeliku, pllaka me trashësi 3 mm, e fiksuar mirë në dyshtemenë e vagonit/dërrasat me vida druri; numri i vidave, për diametër të vidës të paktën 6 mm dhe 60 mm gjerësi të pllakës lidhëse; 6 (3 në takot dhe 3 në dërrasat).

- Stivat që peshojnë mbi 30 tonë duhet të sigurohen duke përdorur gozhdimin e takove sipas pikës 9 dhe fiksimin poshtë pllakave lidhëse;

- I tubave të grasatuar ose të veshura të lëmuara:

Përdoren materiale me koeficientë të lartë fërkimi (μ të paktën 0.7):

11. I rreshtave të ngarkuar në formë bishtdallëndyshe bëhet duke i lidhur së bashku me rreshtat e mëposhtëm së paku me dy lidhëse. Për lidhjet përdoren shiritat me pajisje tërheqëse (tensionuese) (forca e këputjes të paktën 4000 kN).

12. I stivave të tubave bëhet duke i lidhur nga poshtë me shirita të tërhequr me pajisje (forca këputëse të paktën 4000 kN), 1 shirit për çdo 6 m gjatësi tubash, por të paktën 2 për stivë (shiriti vendoset afërsisht 50 cm nga fundi i tubave), duke pasur parasysh dhe kushtet në vijim:

- Kur tubat dalin mbi krahët më tepër se gjysma e diametrit të tyre ose

- Kur distanca është më e vogël se ajo e theksuar në pikën 5 ose

- Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar

- Kur tubat janë të grasatuar ose me veshje të lëmuar dhe në mungesë të pajisjeve me koeficient fërkimi të lartë

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e mallit dhe gabariti i ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Për trafik të destinuar për RENFE, shiritat (fiksimi indirekt) duhet të jenë të tensionuar me pajisjen përkatëse.

Neni 20

Tuba çeliku të ngarkuar në stivë bishtdallëndysheje, në vagonë speciale

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Tuba çeliku me sipërfaqe të çfarëdoshme

Vagonët

Vagonë me krahë të përforcuar dhe me sigurim indirekt me shirita (Sp..., Roo...)

Metoda e ngarkimit

Tubat ngarkohen të sistemuara, si më poshtë:

1. Tubat me diametër të vogël: përgjatë dyshemesë, të puthitur mirë (boshllëku vetëm në një anë).

2. Tubat me diametër të madh: mbështeten te krahët në të dyja anët (boshllëku lihet në qendër).

3. Tubat që janë në pjesën e sipërme të krahëve nuk lejohet të dalin mbi krahët më tepër se gjysma e diametrit të tyre (shih figurën).


4. Tubat që ngarkohen mbi lartësinë e krahëve, vendosen në sistem bishtdallëndysheje dhe sistemohen për sa është e mundur në mënyrë simetrike.

5. Sistemi i ngarkimit bishtdallëndysheje përdoret vetëm kur tubat e rreshtave bazë kanë të njëjtin lartësi.

6. Për vagonët Sp... distancën minimale

- Për tuba me sipërfaqe të papërpunuar	30 cm	0 cm
- Për tuba të grasatuar ose të veshur të lëmuar	50 cm	0 cm

Nuk kërkohet distancë në vagonët Roo



Sigurimi

7. Nëpërmjet krahëve anësorë;

nëse sigurimi bëhet nëpërmjet vetëm dy krahëve nga secila anë, tubat duhet të dalin jashtë qendrave (akseve) të krahëve, të paktën:

- Për tuba me sipërfaqe të papërpunuar	30 cm	20 cm
- Për tuba të grasatuar ose të veshur të lëmuar	50 cm	20 cm

8. Sigurimi i stivave bëhet duke i lidhur poshtë nëpërmjet pajisjeve të vagonit, stivat e vogla; lidhen të paktën dy herë.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Neni 21

Tuba çeliku në lidhje

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Tuba çeliku të lidhura në grupe

Numri i lidhjeve sipas diametrit, gjatësisë së tubave dhe peshës së lidhjes, por të paktën 2 lidhëse për lidhje të shpërndara rregullisht.

Tipi i lidhëseve: shirita çeliku ose shirita sintetikë (forca këputëse të paktën 14 kN)

Vagonët:

Vagonë me krahë dhe sponda ballore (K..., L..., R..., Sa...)

Metoda e ngarkimit:


1. Lidhjet ngarkohen direkt në dyshtemenë e vagonit, ngjitur njëra mbas tjetrës, në traversa bylyk ose dërrasa, dërrasat duhet të jenë nga dru i butë, seksion tërthor katërkëndësh dhe të shtrira nga faqja e gjerë.

2. Në rreshtin e poshtëm, lidhjet janë në kontakt me krahët.
3. Rreshtat e mësipërm të lidhjeve ngarkohen në sistemin bishtdallëndysheje. Për të lehtësuar shkarkimin, midis lidhjeve vendosen elementet ndarëse prej materiali me koeficient fërkimi të lartë të drejtuara sa më vertikalisht.

4. Distanca (hapësira) e lidhjeve me spondin ballor, minimale

50 cm

0 cm



Sigurimi

5. Nëpërmjet krahëve anësore (për rreshtin e poshtëm); nëse sigurimi bëhet vetëm nëpërmjet 2 krahëve nga secila anë, ngarkesa duhet të dalë në drejtimin gjatësor përkundrejt akseve të krahëve, të paktën:

50 cm

30 cm

6. Nëpërmjet ngarkimit sistem bishtdallëndysheje (rreshti i sipërm).

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 22

Çiftet e rrotave hekurudhore

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Çifte rrotash me ose pa kuti kushinetash.

Vagonët

Vagonë me pajisje ndarëse ose sponda dhe dysHEME druri (E..., K..., Re...)

Metoda e ngarkimit

1. Individualisht ose

2. Në grup

3. Hapësirat tërthore në vagon; minimumi 20 cm


- Hapësirat gjatësore në vagon:

4. Midis çifteve të akseve: minimumi 20 cm

5. Me spondin ballor të paktën

1 m

20 cm




Sigurimi

6. Në shtrate druri;
 7. Me lartësi efektive të shtratis minimumi 8 cm; dhe
 8. Gjatësia korresponduese sipas diametrit të rrotës (për akse 840-920 mm = 510); dhe
 9. Fiksimi, përdoren bulona me kokë M10 ose vida – gozhdë 5 x 100 mm, me;
 10. Zmuro në shtratin e drurit në drejtimin gjatësor;
 11. Çifti i rrotave nuk duhet të takojë me dyshe-menë e vagonit.
- Të dhëna shtesë
Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 23

Profile çeliku (të pagrasatuara)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar Vagonë me amortizator me kors të gjatë
Tipi i mallit 1. Profile çeliku rifuzo; ose 2. Të bashkuara në pako, të lidhura çdo 3 metër dhe minimumi 2 lidhje, lidhjet duhet të jenë afërsisht 30 cm, nga fundi i pakos. Forca e këputjes të paktën 1,400 daN. Lidhjet bëhen me shirita të thurur, duke përdorur pajisje mbrojtëse tek anët. Vagonët Vagonë me perde ndarëse, sponde ose krahë dhe dyshe-meja prej druri (E..., K..., L..., S..., T...). Metoda e ngarkimit Profilet dhe pakot ngarkohen direkt në dyshe-menë e vagonit, në traversa bylyk ose dërrasa. 3. Me një ose më shumë rreshta. 4. Në stiva, duke i vendosur njëra mbi tjetrën, kur është e mundur shpërndahet në gjithë gjerësinë e vagonit. 5. Dërrasat dhe mbështetëset. - Me seksion katror ose katërkëndësh, të shtrira përkundrejt faqes së gjerë; - Prej një pjese ose maksimumi prej 3 pjesësh të lidhura (me të paktën 4 cm trashësi), të cilat mbulojnë tërë gjerësinë e mallit ose të njësisë së ngarkesës. 6. Profilet dhe pakot duhet të dalin përtej dërrasave (takove) të paktën 50 cm.	



Sigurimi

Profilet e çelikut ose pakot sigurohen direkt nëpërmjet perdeve ndarëse, spondave ose krahëve (distanca horizontale < 10 cm) ose të lidhura së bashku, në qoftë se distanca është më e madhe se 10 cm; dhe

7. Lartësia efektive e perdeve ndarëse, spondave ose krahëve të paktën 10 cm.

- Hapësirat e ndërmjetme plotësohen me pjesë prej druri (të gozhduara në vend); ose

- Lidhen së bashku në tufa (me mbrojtëse tek anët) me pjesët e poshtme të ngarkesës. Numri i lidhjeve: 1 për çdo 6 m gjatësi, por të paktën 2 lidhje për stivë (forca këputëse të paktën 1.400 daN); ose

- Pa lidhje shtesë për profile të shtrira në anët e vagonit.

8. Profilet e çelikut dhe pakot që ngarkohen në pjesën e sipërme dhe dalin jashtë lartësisë së krahëve më tepër se 10 cm duhet të jenë të lidhura së bashku me pjesën e poshtme të ngarkesës, lidhja bëhet në çdo 6 m gjatësi, por të paktën 2 lidhje për stivë (forca këputëse të paktën 1.400 daN), shiritat janë sintetikë ose të thurur me pajisje mbrojtëse të anëve, distanca e lidhjes nga fundi i ngarkesës, të paktën 50 cm.

9. Nëse sigurohen nëpërmjet dy krahëve, profilet dhe pakot duhet të dalin jashtë krahëve, të paktën:

50 cm

30 cm

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Nisur nga vlerësimi që bëhet në nenin 19, pikën 2; volumi I “Parimet”, është e mundur të vendoset malli me hapësirë (distanca) përkundrejt pajisjeve ndarëse ose spondave dhe kur malli nuk ka prirje të zhvendoset.

Neni 24

Shinat

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

Shina me dimensione të ndryshme

Vagonët



Vagonë me perde ndarëse, sponde ose krahë dhe dyshemeja prej druri (E..., K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

Shinat ngarkohen direkt në dyshemenë e vagonit, në traversa bylyk ose dërrasa.

1. Me një ose disa rreshta, nëse është e mundur në tërë gjerësinë e vagonit.
2. Jo më lart (përmbi) se lartësia e perdeve ndarëse, spondeve dhe krahëve.
3. Dërrasat (takot) e mbështetjes.
 - Me seksion tërthor katërkëndësh (e shtrirë përgjatë faqes së gjerë);
 - Prej një pjese, me gjatësi më të madhe se gjerësia e mallit, me trashësi afërsisht 4 cm.
4. Shinat e ngarkuara duhet të dalin jashtë tubave, të paktën 50 cm.
5. Distancat (hapësirat) minimale:

50 cm | 0 cm



Sigurimi

6. Shinat sigurohen direkt nëpërmjet perdeve ndarëse, spondeve ose krahëve.
7. Kur sigurimi bëhet nëpërmjet vetëm dy krahëve në dy anët, shinat duhet të dalin jashtë aksit të krahëve të paktën:

50 cm | 30 cm

8. Hapësirat e ndërmjetme duhet të plotësohen duke përdorur tako druri (të gozhduara në vend).

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 25

Prokate çeliku dhe profile të tjera në pako (të pagrasatuara)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar Vagonë me amortizator me kors të gjatë
--------------------------------------	---

Vagonë me amortizatorë me kors të gjatë

Tipi i mallit

1. Prokate çeliku dhe profile të tjera, të lidhura në pako me lidhje çdo 3 metra dhe minimumi 2 lidhje për pako.

2. Distanca e lidhjeve nga fundi i pakove: afërsisht 30 cm.

Forca këputëse e shiritave, të paktën 1.400 daN.

Shiritat (lidhëset) janë sintetikë ose të thurur me pajisje mbrojtëse tek anët.

Vagonët

Vagonë me perde ndarëse, sponde ose krahë dhe dyshemeja prej druri (E..., K..., L..., R..., S..., T...).

Metoda e ngarkimit

Pakot ngarkohen direkt në dyshemenë e vagonit, në traversa bylyk ose dërrasa.

-

7. Pakot sigurohen direkt nëpërmjet perdeve ndarëse, spondave ose krahëve të vagonit (distançë < 10 cm). Kur kjo distancë është më madhe se 10 cm, pakot duhet të lidhen së bashku.
8. Lartësia efektive: të paktën 10 cm.
9. Hapësirat e ndërmjetme duhet të plotësohen me tako druri (të gozhduara në vend)
10. Pakot e siguruara nëpërmjet vetëm 2 krahëve në dy anët duhet të dalin përtej aksit të krahëve të paktën:

30 cm


- Nisur nga vlerësimi që bëhet në nenin 19, pikën 2; volumi I “Parimet”, është e mundur të vendoset malli me hapësirë (distanca) përkundrejt pajisjeve ndarëse ose spondave dhe kur malli nuk ka prirje të zhvendoset.

2. Dërrasat (takot) duhet të jenë më të gjata se gjerësia e stivës.

- Me seksionin tërthor katror ose katërkëndësh (të shtrira përgjatë faqes së gjerë);
- Të jenë prej një cope ose maksimumi tri copa. Këto të vendosen të intersektuara me njëra-tjetrën dhe gjatësia e shtrirjes së tyre të tejkalojë gjerësinë e ngarkesës ose të njësisë së ngarkesës (me trashësi të paktën 4 cm).

3. Pakoja duhet të dalë të paktën 50 cm përkundrejt takos së dërrasës.

4. Distanca (hapësira) minimale.



Sigurimi

5. Fletët e llamarinës sigurohen direkt nëpërmjet perdeve ndarëse, spondave ose krahëve.

- Kur sigurimi bëhet nëpërmjet vetëm 2 krahëve në dy anët, fletët e llamarinës duhet të dalin jashtë akseve të paktën

50 cm

30 cm

6. Hapësirat e ndërmjetme duhet të plotësohen duke përdorur tako druri (të gozhuara në vend).

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 27

Shufra çeliku për beton

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

Shufra çeliku për betone, në lidhje

Vagonët

Vagonë me sponda ose krahë dhe me sponda balllore që ulen (K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

1. Lidhjet ngarkohen në 4 rreshta maksimalisht me sistem bishtdallëndyshe, direkt në dyshtemenë e vagonit, në traversa bylyk ose në dërrasa.

Distanca (hapësira) nga:

2. Spondet dhe krahët: afërsisht 10 cm.

3. Spondat balllore të ulur, të paktën një hapësirë vertikale prej 5 cm (të vendosura në tako druri (shih figurën).

4. Distanca: të paktën 50 cm.

5. Lidhjet duhet të dalin jashtë takove të drurit afërsisht 1 m.

Takot e drurit duhet të jenë:


6. Prej një pjese në tërë gjerësinë e vagonit

- Të gozhduara në dyshtenë e vagonit për vagonë pa sponda.

Ngarkesa për vagonë individual.

- Vagonë me akse individuale: maksimumi 75%;

- Vagonë me karreta: maksimumi 85% të limitit të përcaktuar të vagonit konkret.



Sigurimi

7. Lidhjet duhet të sigurohen nëpërmjet spondave dhe krahëve .

- lidhjet e tufave bëhen me tel çeliku me diametër 8 mm ose shirita me forcë këputëse prej 40 kN, këto bëhen:

8. Midis vagonëve; dhe

9. Afërsisht 1 m nga fundi, në vagonët pa sponda.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 28

Shina me gjatësi deri 36 m

Vagonë individualë dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar Vagonë me amortizator me kors të gjatë
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Shina me gjatësi deri 36 m

Vagonët

Vagonë të sheshtë me karretë, me krahë, me spond ballor të ulshëm dhe dyshteme druri (R..., S...).

Metoda e ngarkimit

1. Shinat ngarkohen midis spondave anësore në 4 rreshta maksimalisht, në traversa bylyk ose dërrasa.

Distanca (hapësira) nga:

2. Krahët: afërsisht 10 cm.

3. Spondat ballore të ulura të vagonëve të sheshtë: të paktën 5 cm në drejtim vertikal.

4. Spondat ballore të paktën 50 cm (shihni figurën).

Shinat duhet të dalin:

5. Jashtë takove dhe traversave bylyk në distancë 1 m deri në 3 m.

6. Jashtë krahëve fundorë të pajisur me pajisje plotësuese në distancë midis 1 deri 3 m (nëse ndonjë krah në vazhdim ekziston dhe nuk del nevoja e përdorimit, ai duhet të ulët).

Takot duhet të përgatiten nga dru i cilësisë së lartë.


7. Të jetë prej një cope dhe gjatësia sa tërë gjerësia e vagonit; dhe

- seksioni tërthor të jetë afërsisht 15 x 18 cm për takot e dyshemesë, dhe afërsisht 8x12 cm për takot midis rreshtave, dhe duhen:

- 4 tako për të gjithë gjatësinë e vagonit, përfshirë 2, nëse është e mundur, mbi qendrën e karretës

- Sipërfaqja mbështetëse të jetë e grasatuar.

Ngarkesa për vagon maksimumi 85% e limitit të përcaktuar për rastin konkret



Sigurimi

Shinat duhet të sigurohen:

8. Në drejtimin anësor nëpërmjet krahëve; dhe

9. Në pjesët fundore vendosen pajisje plotësuese të fiksuara në krahët fundorë dhe që nuk lëvizin nga vendi.

Dërrasat (takot) që vendosen në dyshemenë e vagonit duhet të gozhdohen në dysheme ose të pajisen me thumba çeliku që rrisin aftësitë kapëse të takos kundrejt dyshemesë.

10. Dërrasat midis rreshtave duhet të sigurohen në një distancë 5 cm nga shinat me tako ose pajisje metalike (që fiksohen në fund të dërrasës) shih figurën.

11. Hapësirat e ndërmjetme duhet të plotësohen me tako dërrase (të fiksuara në vend) ose ndryshe rreshti i sipërm duhet të lidhet me tel çeliku me diametër 5 mm (dy herë).

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabaritit të ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Neni 29

Shina me gjatësi > 36 m dhe deri 150 m

Tipi i mallit

Shina me gjatësi më të madhe se 36 m dhe deri 150 m

Vagonët

Vagonë të sheshtë me karreta me dysheme druri (R..., S...)

Metoda e ngarkimit

Shinat mund të ngarkohen me 3 rreshta maksimalisht

1. Të mbështetura në qendër me pajisje mbajtëse

Në çdo vagon ku bëhet ngarkesa me shina ato mbështeten në:

2. Në dy konstruksione të veçanta, të vendosura përkundrejt qendrave e karretave, dhe nëse është e mundur:

3. Në një tako dërrase

4. Në drejtimin gjatësor të vagonit, shinat duhet të dalin jashtë konstruksioneve të veçanta afërsisht 1.5 deri 3 m.

Distanca (hapësira) nga:

5. Spondat ballore të ulura: afërsisht 5 cm vertikalisht.

6. Spondat ballore të paulura, të paktën 1.5 m.




7. Konstruksioni i veçantë, afërsisht 10 cm.

Pajisja mbështetëse e konstruksioni i veçantë përgatiten nga profile çeliku – U dhe janë: - të fiksuara me thumba çeliku në dyshemenë e vagonit

8. Për drejtimin e fiksimit të takove dhe traversa bylyk.

9. Të adaptuara në gjerësinë e ngarkimit duke përdorur pajisje shtesë.

10. Pajisja mbështetëse vendoset në dyshemenë nëpërmjet lidhjeve (forca këputëse të paktën 1.000 daN).



Dërrasat duhet të përgatiten nga dru i fortë

11. Prej një pjese, të gjata sa gjerësia e vagonit dhe të shtrira përgjatë faqes së gjerë, me:

- Seksion tërthor afërsisht 15x18 cm për dyshemenë; dhe

- Seksion tërthor afërsisht 8 x 15 për dërrasat e rreshtave të ndërmjetëm.

Sipërfaqet mbështetëse grasatohen (përfshihen ato që vendosen në pajisjen mbështetëse).

Takot e ndërmjetme midis pajisjes mbështetëse dhe konstruksioneve të veçanta duhet të:

12. Prodhen nga profile çeliku të inkastruara në dru të fortë (shih figurën), të pajisen me stopues në pjesën fundore dhe të kenë:

13. Distanca nga shinat afërsisht 5 cm, të jenë;

14. Të fiksuara poshtë e lart, lartësia stopuese afërsisht 5 cm.

Ngarkesa e vagonit 85% e limitit të ngarkimit.

Sigurimi

15. Në mënyrë të dyfishtë me shtrëngim në pajisjen mbajtëse.




16. Në drejtimin anësor nëpërmjet konstruksionit të vagonit.

Gjatë lëvizjes shinat nuk takojnë me konstruksionin e vagonit; dhe

17. Sigurimi kundrejt shembjes së rreshtave bëhet duke lidhur pjesën e fundit të ngarkesës me konstruksionin e vagonit (forca këputëse të paktën 5.000 daN).

18. Me pajisje të mbrojtura në anët.



19. Distanca nga fundi i vagonit të paktën 1 m



Të dhëna shtesë

Shihni vizatimet shtesë të komponentëve.

Konsiderohen transport i veçantë BDZ, EËS, GySEV, FS, HZ, JZ, OBB, PKP, RENFE, GC (SJ), SNCB, SNCF, SZ dhe TCDD; dhe transport normal me tren bllok për anëtarët e tjerë.



Shina (të ngarkuara në disa vagon të sheshtë)

Tipi i mallit

Shina me gjatësi më të madhe se 36 m dhe deri në 150 m

Vagonët

Vagonë të sheshtë me karretë, me krahë të përforcuar (nga profili I të zmontueshëm) me sponda ballore që ulend he dysheme druri (Samms)

Metoda e ngarkimit

1. Shinat ngarkohen midis krahëve në 3 rreshta në maksimum, në traversa bylyk ose dërrasa Distanca (hapësira) të

2. Krahët anësore afërsisht 10 cm

3. Spondi ballor i ulur (distanca vertikale) të paktën 5 cm

4. Spondat ballore të ngritura (me pozicion normal) të vagonëve fundor për gjatësi të shinave prej:

- | | |
|----------------------|-------------------|
| - deri në 60 m | të paktën 75 cm, |
| - > 60 m deri 90 m | të paktën 1 m, |
| - > 90 m deri 120 m | të paktën 1.25 m, |
| - > 120 m deri 150 m | të paktën 1.50 m |

Shinat duhet të dalin:

5. Përtej takove dhe bylyk midis 1.5 deri 3 m

6. Përtej krahëve fundor të pajisur me pajisje plotësuese në distancën midis 1.5 deri 3 m (nëse ndonjë krah në vazhdim ekziston dhe nuk del nevoja e përdorimit, ai duhet të ulët)

Takot duhet të përgatiten nga dru i shëndetshëm dhe


7. Të jenë prej një cope dhe gjatësi sa gjerësia e vagonit dhe

- Seksioni tërthor të jetë afërsisht 15 x 18 cm për takot e dyshemesë, dhe afërsisht 8 x 15 për takot midis rreshtave me

- 4 tako për gjithë gjatësinë e vagonit, përfshirë 2 në afërsi të qendrës së karretës, të baraslarguara nga krahët dhe

- Sipërfaqja mbështetëse të jetë e grasatuar.

Ngarkesa për vagon maksimumi 85% i limitit të përcaktuar për rastin konkret



Sigurimi

Shinat duhet të sigurohen:

8. Në drejtimin anësor nëpërmjet krahëve (të gjithë krahët në zonën e ngarkesës duhet të jenë të ngritur).

9. Nëpërmjet pajisjeve plotësuese, të përgatitura nga profile çeliku, të vendosura në krahët e vagonëve fundorë e të ndërmjetëm në një distancë afërsisht 40 m. Kjo pajisje duhet t'i përshtatet seksionit tërthor të krahut të vagonit, të montohet e fiksuar e siguruar; dhe

10. Krahët e vagonit të pajisur me këtë pajisje, lidhen në pjesën e sipërme (krahët përballë njëri-tjetrit) me tel të dubluar me diametër 8 mm.

Takot (dërrasat) e shtrira në dysheme duhet të gozhdohen në vend.

11. Lëvizjet anësore në pjesën fundore të dërrasave duhet të kufizohen nëpërmjet takove prej kompensate ose prej morsetave metalike me lartësi 5 cm të fiksuara në fund të dërrasës (nëpërmjet bulonave shtrëngues). Distanca midis këtyre takove dhe shinave është 5-8 cm.

Nëse rreshti i sipërm nuk është i plotësuar.

12. Hapësira (distanca) që ngelet bosh në drejtimin tërthor, plotësohet në të gjithë gjatësinë e vagonit me tako dërrase të fiksuara me vida; ose

- rreshti i sipërm duhet të lidhet në qendër me tel çeliku (2 herë) me diametër 5 mm.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja ngarkesës: shih nenin 2.

Ngarkesa e vagonit për BDZ, EËS, GySEV, FS, HZ, JZ, OBB, PKP, RENFE, GC (SJ), SNCB, SNCF, SZ dhe TCDD; ngarkesë normale për tren bllok për anëtarët e tjerë.

Neni 31 Pllaka çeliku

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

Pllaka çeliku të prodhuara me derdhje, sipërfaqe e papërpunuar me seksion katërkëndësh.

Vagonët

Vagonët me sponda ose krahe dhe me dysheme dërrase (K..., L..., R..., S..., Sa...).

Metoda e ngarkimit

1. Pllakat ngarkohen direkt në dyshemenë e vagonit, në traversa bylyk ose mbi dërrasa.

- Shpërndarja bëhet në të gjithë gjerësinë për sa është e mundur;

- Pllakat e të njëjtës lartësi vendosen njëra mbi tjetrën, sidoqoftë stivat individuale nuk duhet të kenë lartësi më të madhe se gjerësia e pllakave;

- Stiva bëhet me 4 rreshta maksimalisht; në stivë midis pllakave vendosen 2 tako, në mënyrë që pllakat të mos takojnë me njëra-tjetrën.

2. Dërrasat (takot) duhet:

- Të jenë prej druri me trashësi minimale 3 cm, me seksion katërkëndësh (kënddrejtë) të mbështetura përgjatë faqes së gjerë; dhe


- Të jenë prej një cope ose maksimumi 2 pjesë të shtrira në të gjithë gjerësinë e ngarkesës;

- Të jenë të vendosura në mënyrë të tillë që pllaka të dalë të paktën 50 cm.

3. Distancat (hapësirat) minimale

50 cm

0 cm



Sigurimi

4. Nëpërmjet spondave dhe krahëve, lartësia minimale efektive: 10 cm.

5. Kur sigurimi bëhet vetëm midis 2 krahëve, pllakat duhet të dalin jashtë krahëve të paktën:

50 | 30 cm

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 32

Rrjetat metalike - kafaze

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

1. Rrjeta metalike të lidhura në stivë nëpërmjet 2 telave prej çeliku me diametër të paktën 4 mm.

Vagonët

Vagonët me krahë me dysHEME dërrase (K..., L..., R..., S...).


Metoda e ngarkimit

2. Në stivë me shumë rreshta, ngarkohet direkt në dysHEME, në traversa bylyk ose dërrasa

3. Distancat (hapësirat) minimale

30 cm | 0 cm

4. Stivat e ngarkuara mbi lartësinë e krahëve, gjerësia e stivës në këtë rast duhet gjithmonë të shikohet në lidhje me gabaritin e ngarkesës, ajo në çdo rast duhet të ketë një diferencë prej 10 cm, kjo për të siguruar lëvizjen nga lëkundjet që mund të ketë stiva.



Sigurimi

5. Stivat sigurohen nëpërmjet krahëve.

6. Kur sigurimi bëhet nëpërmjet vetëm 2 krahëve, stiva duhet të dalë përtej aksit të krahëve të paktën:

30 | 20 cm

Stivat e siguruara me lidhje indirekte duhet të përdoren të paktën 2 shirita; dhe

7. Distanca nga fundi i stivës rreth 50 cm.

8. Tipi i lidhjes: shirita të endur me mbrojtëse të anëve (forca këputëse të paktën 40 kN) me pajisje tensionuese ose litar çeliku (me diametër minimal 8 mm) me pajisje tensionuese.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shih nenin 2 dhe 3.

Neni 33

Rrjeta metalike në rulona

Tipi i mallit

Rrjeta metalike në rulona të lidhura të paktën 2 herë me tel çeliku me diametër 4 mm minimalisht.

Vagonët

Vagonë me perde ndarëse ose sponda dhe krahë fundorë dhe sponda me dyshe me dërrase (E..., K..., Re).

Metoda e ngarkimit


Rulonat ngarkohen

1. Direkt në dyshe të vagonit; dhe

- Vendosen gjatë aksit tërthor të vagonit; ose

- Vendosen në shumë rreshta me sistemin bishtdallëndyshe.

2. Stivat e ngarkuara mbi lartësinë e krahëve, gjerësia e stivës në këtë rast duhet gjithmonë të shikohet në lidhje me gabaritin e ngarkesës, ajo në çdo rast duhet të ketë një diferencë prej 10 cm, kjo për të siguruar lëvizjen nga lëkundjet që mund të ketë stiva.



Sigurimi

Rulonat duhet të sigurohen si në vijim:

3. Nëpërmjet spondave të vagonit, në këtë rast rreshti i sipërm duhet të plotësojë kushtin që pjesa e rulonit që del mbi sponde të jetë më e vogël se gjysma e diametrit të rulonit;

- Nëpërmjet krahëve të vagonit.

4. Nëpërmjet lidhjes, të paktën 2 lidhje në drejtimin gjatësor dhe të paktën 1 lidhje në çdo 3 m në drejtimin tërthor, lidhjet tërthore duhet të kalojnë mbi lidhjet në drejtim gjatësor (lidhjet duhet të kenë një forcë këputëse të paktën 10 kN); dhe

5. Rulonat që ndodhen ngjitur me krahët ballor, në lartësinë maksimale të krahëve janë të siguruar, kur lartësia që del jashtë krahut është më e vogël se gjysma e diametrit të rulonit; dhe

6. Rulonat që ndodhen në rreshtat mbi krahët lidhen së bashku dy herë me tel çeliku me diametër 4 mm.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Bobina shufra çeliku (të çdo lloji diametri) ngarkuar në pale

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonë me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Bobina shufra çeliku

- Me diametra të ndryshëm të shufrës;
- Diametri i bobinës midis 1.100 deri 1.300 mm;
- Gjatësia e bobinës: 1.100 deri 2.400 mm;
- Masa e njësisë: 1.100 deri 2.400 kg.

1. Kujdes i veçantë duhet të tregohet gjatë përgatitjes së bobinës. Çdo bobinë duhet të jetë e lidhur me të paktën katër shirita (forca minimale e këputjes 1.400 dN), të shpërndarë në mënyrë të rregullt në tërë periferinë e bobinës.

Bobinat e palidhura janë të shthurura e ngatërruara

Vagonët

Vagonët të sheshtë me dysHEME dërrase, me krahë dhe sponda ndarëse (K..., Re...)


Metoda e ngarkimit

Bobinat shufra çeliku ngarkohen në drejtimin gjatësor të vagonit (në palë).

2. Direkt mbi dysHEME e vagonit, në dy rreshta të rregulluar, duke respektuar aksin gjatësor të vagonit.

3. Në kontakt me spondat ndarëse ose vendosur me pengesa (tako).

4. Mbi 2 rreshtat e mëposhtëm vendoset një rresht tjetër. Ky rreshti i sipërm i vendosur në formë bishtdallëndyshe duhet të jetë më i shkurtër 50 cm në të dyja anët e rreshtave të mëposhtëm.



Sigurimi

Në drejtimin gjatësor të vagonit

5. Nëpërmjet spondit ballor

Në drejtimin tërthor të vagonit

6. Bobinat në rreshtat e mëposhtëm vendosen në kontakt me spondat ndarëse.

7. Nëpërmjet vendosjes së pengesave, bobina sigurohet duke përdorur tako të gozhduara (seksion tërthor minimal i takos 90 x 90 cm).

Të dhëna shtesë

8. Në varësi të kualitetit të produktit, ekzistojnë disa forma ruajtje (sigurimi) (plastika, kartoni etj.), që vendosen midis bobinës e spondit ndarës.

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 35

Bobina shufra çeliku të ngarkuara në radhë

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar Vagonë me amortizator me kors të gjatë
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Bobina prej shufra çeliku

- Diametri i shufrës 9 mm;
- Diametri i bobinës midis 1.100 deri 1.300 mm;
- Gjatësia e bobinës: 1.100 deri 2.400 mm;
- Pesha e bobinës: 1.100 deri 2.400 kg.

1. Kujdes i veçantë duhet të tregohet gjatë përgatitjes së bobinës. Çdo bobinë duhet të jetë e lidhur me të paktën katër shirita (forca minimale e këputjes 1.400 dN), të shpërndare në mënyrë të rregullt në tërë periferinë e bobinës.

Bobinat e palidhura janë të shthurura e të ngatërruara.

Vagonët

Vagonët të sheshtë me dysHEME dërrase, me krahë dhe sponda ndarëse (K..., Re...).

Metoda e ngarkimit

Bobinat prej shufra çeliku ngarkohen.


2. Në radhë (rresht) direkt mbi dysHEME e vagonit, në dy rreshta të rregulluar duke respektuar aksin gjatësor të vagonit.

3. Në kontakt me spondat ndarëse.

4. Në kontakt me spondin ballor të vagonit.

5. Mbi 2 rreshtat e mëposhtëm vendoset një rresht tjetër i ngarkuar në sistem bishtdallëndysheje i qendërzuar sipas aksit gjatësor të vagonit.

Pozicionet e para (në afërsi të fillimit dhe fundit të vagonit) duhet të jenë të lira (të mos ngarkohen me bobinë), kjo nënkupton rreshtin e dytë (të sipërm).



Të dhëna shtesë

6. Në varësi të kualitetit të produktit, ekzistojnë disa forma ruajtjeje (sigurimi) (plastika, kartoni etj.), që vendosen midis bobinës e spondit ndarës.

Shpërndarja e ngarkesës: shih nenin 2.

Neni 35

Skrapi i lehtë

Tipi i mallit

Skrapi i lehtë, ngarkuar në mënyrë të parregullt (rifuzo)

- Lllamarina çeliku (pavarësisht nga formati, sipërfaqja dhe trashësia);

- Pjesë skeletesh;

- Ashkla çeliku;

- Pjesë të prera metalike;

- Përzierje me pjesë të lehta dhe të rënda skrapit;


- Automjete të presuara etj.

Vagonët

Vagonë me sponda të larta (E..., Fab...)

Metoda e ngarkimit

1. Skrapi duhet të shpërndahet në mënyrë uniforme dhe nuk duhet të ngarkohet mbi lartësinë e spondave, nënkuptuar kjo lartësi dhe përkundrajt aksit gjatësor.



Sigurimi

2. Skrapi duhet të mbulohet në gjithë sipërfaqen e vagonit (dhe kur kemi skrap miks ose të përzier me skrap të rëndë).

Materiali mbulues:

- Rrjeta metalike (rrjeta standarde prej teli çeliku);

- Dimensioi i kuadrateve të rrjetës (brimave) 100 mm maksimumi;

- Rrjeta sintetike; me

- Gjerësia afërsisht 3.80 m;

- Dimensioi maksimal i kuadratit 30 mm;

- Forca këputëse gjatësore të paktën 390 N¹;

- Forca këputëse anësore të paktën 480 N¹.

3. Mbulesa duhet të lidhet afërsisht çdo 2 m:

- Me shirita jometalike (për rrjeta standarde prej teli çeliku, lidhja me tel është e pranueshme), forca këputëse lidhëse afërsisht 5 kN; dhe

¹ Testi i shtrëngimit mund të kryhet në një mostër 10 cm gjerësi, përfshi 3 thyerje.

4. Anët e rrjetave mbuluese lidhen me shirita.
5. Lidhja bëhet dhe në pjesën e sipërme të mjeteve.
6. Lidhëset fiksohen te grepat e vagonëve (greqat ekzistojnë në vagonët tip Eanos).

Të dhëna shtesë

7. Skrapi nuk duhet të ngjishet ose të dalë mbi lartësinë e spondave.

Ngarkimi rifuzo i skrapit mund të shkaktojë që gjatë lëvizjes të dalë mbi spondat e vagonit. Duhet që kjo të kufizohet me masa të mjaftueshme, si me mbulim me rrjetë ose me sondat.

Neni 36 Skrapi i rëndë

Tipi i mallit

Skrapi i rëndë, ngarkimi bëhet me grumbull (rifuzo)

- Pjesë çeliku të derdhura e pjesë të tjera çeliku;
- Ashkla e mbetje çeliku;
- Pjesë ose profile të prera çeliku ose pjesë tubo të prera;
- Skrap çeliku prej konstruksioneve të copëtuara (të prera);
- Shina të prera dhe pjesë çeliku të derdhura;
- Skrap i presuar (briket);
- Automjete të papresuara etj.


Vagonët

Vagonë me sponda të larta (E..., Fab...)

Metoda e ngarkimit

Skrapi shpërndahet në mënyrë uniforme dhe ngarkohet:

1. Jo më e lartë se afërsisht 10 cm nën lartësinë maksimale të spondit (kjo, gjithashtu, dhe gjatë aksit gjatësor të vagonit); dhe
2. Skrapi i presuar (briket), automjete të papresuara, makineri etj., mund të ngarkohen afërsisht deri në niveli e spondave.



Sigurimi

Pjesë të skrapit që kanë prirje të lëvizin nga rryma e ajrit, të tilla si elemente llamarinash, dyer të mjeteve të ndryshme, të cilat janë ngarkuar në pjesën e sipërme të vagonit duhet të sigurohen me rreshta.

Të dhëna shtesë

3. Skrapi nuk duhet të ngjeshët ose të dalë jashtë spondave (të tejkalojë lartësinë efektive të spondave).

Forcat që ushtrohen në ngarkesë gjatë lëvizjes mund të shkaktojnë lëvizjen e pjesëve dhe të dalin mbi lartësinë e spondave, duhet që kjo të kufizohet me masa të mjaftueshme të sigurimit, si p.sh. nëpërmjet spondave.

Për skrap miks (të përzier) dhe skrap i lehtë, shihni neni 35.

LËNDË DRURI

Neni 37

Trupa druri të papërpunuara

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonë me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Trupa druri të papërpunuara me apo pa lëvore të dimensioneve të ndryshme.

Vagonët

Vagonët me perde ndarëse, sponda ose krahë (E..., K..., L..., R..., S...).

Metoda e ngarkimit

Trupat

- Ngarkohen në drejtimin gjatësor të vagonit.

1. Të ngarkuar në rreshtin e sipërm mund të dalin mbi lartësinë e perdeve, spondave e krahëve në një lartësi jo më të madhe se gjysma e diametrit të trupit.

- Me diametër më të vogël se 20 cm, lartësia efektive duhet të jetë 10 cm;



- Me diametër më të vogël se 10 cm mund të ngarkohen vetëm poshtë rreshtit të sipërm dhe të jenë në kontakt me krahët ose perdet ndarëse.

2. Sipër lartësisë së perdeve ndarëse ose krahëve trupat ngarkohen në sistem bishtdallëndysheje, lartësia maksimale e sistemit të kurbuar mund të jetë maksimalisht sa 1/3 e gjerësisë së ngarkesës.

- Në qoftë se trupat e ngarkuar janë në lartësinë sa gjysma e lartësisë së krahëve.

3. Krahët e rrotullueshëm duhet të fiksohen me tako; ose

4. Krahët lidhen në mënyrë të dyfishtë me tel me diametër 4 mm ose shirita (forca e këputjes minimale 10 kN) në nivelin e gjymës së lartësisë së krahëve.



Sigurimi

5. Trupat me diametër mbi 70 cm (matur kjo në pjesën me diametër më të vogël) të ngarkuar në vagonët K..., L..., dhe R..., vagonët duhet të sigurohen nga ana anësore me të paktën 3 tako, takot duhet të kenë lartësi të paktën 12 cm (të gozhdohen me të paktën 3 gozhdë për tako, dimatri i gozhdëve të jetë 5 mm).

6. Trupat që qëndrojnë përkundrejt krahëve duhet të sigurohen nëpërmjet të paktën 2 krahëve.

Kur sigurimi bëhet nëpërmjet vetëm 2 krahëve.

7. Trupat duhet të dalin në drejtimin gjatësor jashtë qendrës së krahëve të paktën:

50 cm | 30 cm

Për trupat me lëvozhgë, të paktën:

30 cm | 20 cm

8. Trupat të cilët sigurohen nëpërmjet perdeve të vagonëve ose krahëve dhe të cilët dalin mbi këto, me tepër se gjysma e diametrit të tyre duhet të sigurohen me të paktën 2 lidhje (ose shirita) me një forcë këputëse të paktën 10 kN.

9. Distanca midis lidhjeve dhe fundeve të trupave duhet të jetë rreth 50 cm.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shih nenet 2 dhe 3.

Neni 38

Dërrasa të sharruara me seksion katërkëndësh, të pastra dhe të lidhura me pako

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonë me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Dërrasa të sharruara me seksion katërkëndësh, të pastra dhe të lidhura në pako me dy lidhëse (forca këputëse minimale 700 daN).

Vagonët

a) Vagonë të sheshtë me krahë dhe dyshme druri, me ose pa perde ndarëse (K.(i)...L.(i)..., R.(i)..., S...), me ose pa mbulesë mekanike.

b) Vagonë me perde rrëshqitëse ose çati metalike (H..., K.i..., S.i...).

Metoda e ngarkimit


Pakot e dërrasave ngarkohen njëra mbas tjetrës dhe njëra mbi tjetrën. Pakot me dimensione të njëjta duhet kur është e mundur të vendosen njëra mbas tjetrës dhe një në pjesën e sipërme të tyre ose, kur është e mundur, pakot individuale mund të vendosen në pjesën e mesit të stivës dhe kur pakot e poshtme kanë lartësi të njëjtë.

Pakot me gjatësi jo të njëjtë ngarkohen në mënyrë sa më kompakte të mundshme.

1. Pakot vendosen në traversa bylyk ose dërrasa prej një pjese, dhe që janë të gjata sa gjerësia e vagonit.

2. Dërrasat (takot) me seksion katërkëndësh dhe të shtrira nga faqja e gjerë¹ – mund të përgatiten nga disa pjesë me të njëjtën trashësi, që lidhen në fundet e tyre, kur është ky rast, sidoqoftë numri i pjesëve të drurit duhet të jetë jo më i madh se numri i pakove që vendosen njëra mbas tjetrës.

3. Dërrasat (takot) vendosen rreth 50 cm larg fundit të pakove.



¹ Dërrasat (takot) me seksion tërthor katror (të paktën 6 x 6cm) janë pranuar, me kusht që të gjitha anët e takove të jenë kënddrejtë (të mprehta).

Sigurimi

Pakot me gjatësi jo të njëjtë, sigurohen poshtë në çdo drejtim gjatësor të vagonit siç tregohet në pikat 4 dhe 8.

Stiva duhet:

Të sigurohet nëpërmjet spondave¹ dhe/ose krahëve¹ ose nëpërmjet perdeve fundore dhe perdeve rrëshqitëse/mbulesave¹.

4. Lartësia efektive e spondave ose krahëve duhet të jetë së paku 10 cm.

5. Të sigurohet nëpërmjet të paktën 2 lidhjeve (forca këputëse minimale 1000 dN) ose nëpërmjet shiritave me pajisje shtrënguese, të vendosura në mes të pakos (forca këputëse minimale 4000 kN).

6. Lidhja të paktën 30 cm nga fundi i stivës.

Kur sigurohen nëpërmjet vetëm dy krahëve.

7. Pakoja duhet të dalë në drejtimin gjatësor përkundrejt akseve të krahëve të paktën

30 cm | 20 cm

8. Në mungesë të një çifti krahësh ose sigurimi nuk është në pajtim me pikën 7, sigurohen nëpërmjet lidhjeve indirekte të veçanta (p.sh. shirita) në forcë këputëse të paktën 1000 daN.

9. Të sigurohen në çdo drejtim gjatësor duke përdorur dy tako të gozhduara në pjesën e sipërme dhe poshtë me një gozhdë (diametri $\varnothing$ 5 mm) për 2000 kg peshë të ngarkesës dhe të paktën 2 gozhdë për tako ose pakot individuale të rreshtit të sipërm dhe pakot në afërsi, në qoftë se nuk janë në pajtim me pikën 4 duhet.

10. Të lidhen dy herë (forca këputëse e lidhjeve të paktën 700 daN) me rreshtat e vendosur poshtë dhe të sigurohet nëpërmjet krahëve.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shih nenet 2 dhe 3.

Neni 39

Dërrasa të sharruara, jouniformë, të lidhura në pako

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonë me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

- Dërrasa të sharruara të gjatësive të ndryshme (diferenca maksimale në gjatësi; 25% e gjatësisë së dërrasës më të gjatë), të lidhura në pako.

- Pako me ose pa gjatësi të njëjtë dërrasash, me gjatësi të paktën 4 m;

- Pakot lidhen në tri pozicione me forcë këputëse të paktën 700 daN.

Vagonët

Vagonë të mbuluar ose të hapur (R..., K..., L..., O..., H..., S...)

Metoda e ngarkimit

1. Pako me lartësi të njëjtë në stiva kompakte (të shtrënguara).


2. Pakot në rreshtin e poshtëm me gjatësi të njëjtë dërrasash, duhet të vendosen në tako të tjera me lartësi sa dërrasat e pakove dhe në një distancë 30 cm nga dërrasat e pakos.

3. Dërrasat me gjatësi jo të njëjtë mund të jenë afërsisht 60 cm me të dala nga fundi i pjesës uniforme të pakos.

Dërrasat me gjatësi jo të njëjtë duhet të radhiten në mënyrë uniforme përkundrejt vertikaleitetit.

4. Mund të vendoset një pako në pjesën e sipërme të stivës.

¹ Gjithashtu, pa pjesë drejtuese në qoftë se është më tepër se 10 cm nga spondat ose krahët.



Sigurimi

Stivat sigurohen nëpërmjet perdeve, spondave ose krahëve.

5. Lartësia efektive e perdeve, spondave ose krahëve duhet të jetë të paktën 10 cm.

6. Stiva duhet të dalë në drejtimin gjatësor jashtë krahëve, të paktën:

30 cm | 20 cm

7. Stiva sigurohet nëpërmjet të paktën 2 lidhjeve ose nëpërmjet fashimit (lidhjes gjatë perimetrit) të stivës (forca këputëse e lidhjes të paktën 1.000 daN) lidhja bëhet e shtrënguar në pjesën e dërrasave me gjatësi jo të njëjtë.

8. Rreshti i sipërm sigurohet nëpërmjet 2 lidhjeve me rreshtin e mëposhtëm (forca këputëse të paktën 1.000 daN), shihni pikën 7 për sigurimin e lidhjeve.

Të dhëna shtesë

Shihni informacionin në nenet 2 dhe 5.

Neni 40

Lëndë druri në lidhje

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

Lidhjet formohen me drunj të rrumbullakët, copa ose dru zjarri, të lidhura në mënyrë që copat e drurit mos të bien nga lidhja.

- Minimumi 2 lidhëse për lidhje (forca këputëse të paktën 7 kN);

- Dhe të paktën 4 lidhëse për lidhje mbi 4 m të gjata.

Vagonët

Vagonë me perde, sponda ose krahë (E..., K..., L..., R..., S...).

Metoda e ngarkimit


Lidhjet ngarkohen në drejtimin gjatësor të vagonit e

1. Vendosen të ngjitura me njëra-tjetrën

2. Lidhjet në kontakt me perdet ose krahët nuk duhet të dalin mbi to, më tepër se sa gjysma e diametrit të tyre.

- Lidhjet që dalin mbi perdet ose krahët nuk duhet të dalin mbi to, më tepër se sa gjysma e diametrit të tyre.

3. Nëse pjesë të ngarkesës mbështeten përkundrejt krahëve në një lartësi më të madhe se gjysma e lartësisë së krahut, krahët përkundrejt njëri-tjetrit duhet të lidhen së bashku në mesin e lartësisë së tyre (forca këputëse e lidhëseve duhet të jetë të paktën 10 kN).



Sigurimi

Kur sigurohet me vetëm dy krahë në secilën anë, lidhjet duhet të dalin jashtë qendrave të krahëve në drejtimin gjatësor të paktën

30 cm

20 cm

4. Lidhjet të cilat dalin mbi perdet ose krahët më tepër se gjysma e diametrit të tyre duhet të sigurohen me të paktën 2 lidhje indirekte (forca këputëse të paktën 10 kN).

Seksioni i kurbuar i ngarkesës duhet të jetë maksimalisht sa 1/3 e gjerësisë së ngarkesës.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shihni nenet 2 dhe 3.

Neni 41

Traversa druri (me pako)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

1. Traversa druri, të paimprenjuara dhe të paketuara.

2. Traversat e të njëjtit dimension vendosen në rreshta në pako e lidhen me të paktën 2 shirita (forca këputëse e lidhjeve të paktën 10 kN).

3. Distanca e lidhjeve nga fundi i pakove të paktën 30 cm.

Vagonët

Vagonë me perde, sponda dhe/ose krahë (E..., K..., L..., Re..., Roos..., Snps...).

Metoda e ngarkimit

Pakot ngarkohen në drejtimin gjatësor.

Me një ose disa rreshta, sipas mundësive ngarkesa shpërndahet në gjithë gjerësinë e vagonit.

4. Direkt në dyshemenë e vagonit, në traversa bylyk ose pajisje dërrase (tako).

- Takot të jenë me seksion katërkëndësh dhe shtrihen përgjatë faqes së gjerë;


- Takot të jenë prej një pjese ose disa pjesë të lidhura të së njëjtës trashësi dhe vendosen njëra mbas tjetrës, kur është ky rast, numri i dërrasave nuk duhet të jetë më i madh se numri i pakove.

5. Distanca (hapësira) minimale (me përjashtim të vagonëve E dhe Roos).

30 cm

20 cm

6. Pakot duhet të dalin jashtë takove të paktën 50 cm.



Sigurimi

Pakot duhet

7. Të sigurohen nëpërmjet perdeve, spondave dhe krahëve me lartësi efektive të paktën 10 cm.

8. Të sigurohen nëpërmjet të paktën 2 lidhjeve indirekte (forca këputëse të paktën 10 kN), ose me një shirit me pajisje shtrënguese në qendër të pakos dhe forcë këputëse të paktën 40 kN.

9. Lidhja bëhet afërsisht 50 cm larg nga fundi i stivës.

Kur sigurimi bëhet nëpërmjet vetëm 2 krahëve në secilën anë.

10. Pakoja duhet të dalë jashtë qendrave të krahëve në drejtimin gjatësor, të paktën:

30 cm | 20 cm

- Në mungesë të çifteve të krahëve ose nuk ka pajtim me pikën 10, sigurimi bëhet me lidhje indirekte shtesë, forca këputëse të paktën 10 kN (p.sh. shirita, banda).

11. Sigurimi anësor bëhet me tako të gozhduara, nëse distanca midis stivës dhe krahëve anësore është më tepër se 10 cm; totali i numrit të gozhdëve me diametër 5 mm përgjatë secilës anë; 1 gozhdë për 2000 kg peshë të mallit, për minimumi të paktën 2 gozhdë për tako.

Pakot individuale të rreshtit të sipërm dhe pakot ngjitur, në qoftë se nuk janë në pajtimi me pikën 7 duhet:

12. Të sigurohen nga ana anësore me tako të gozhduara sipër e poshtë; numri total i gomave me diametër 5 mm përgjatë anës; 1 gozhdë për 2000 kg ngarkesë (të paktën pa tako).

13. Të lidhet dy herë (forca këputëse të paktën 10 kN).

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shihni nenet 2 dhe 3.

Neni 42

Traversa druri, të imprenjuara (në pako)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

1. Traversa druri, të trajtuara me katran dhe në pako.

2. Traversa e të njëjtit dimension, vendosen në rreshta në pako e lidhen me të paktën 2 shirita (forca këputëse e lidhjeve të paktën 10 kN).

3. Distanca e lidhjeve nga fundi i pakove të paktën 30 cm.

- Madhësia maksimale e paketimit: 5 rreshta nga 4 traversa për rresht.

Vagonët

Vagonë me perde, sponda dhe krahë (E..., K..., L..., Re..., Roos..., Snps...)

Metoda e ngarkimit

- Pakot ngarkohen në drejtimin gjatësor;

- Në një ose disa rreshta, sipas mundësive ngarkesa shpërndahet në gjithë gjerësinë e vagonit.

4. Direkt në dyshtemenë e vagonit, në traversa bylyk ose pajisje dërrase.

- Dërrasat të jenë me seksion katërkëndësh dhe shtrihen përgjatë faqes së gjerë;


- Dërrasat të jenë prej një pjese dhe të mbulojë gjithë gjerësinë e vagonit.

5. Distanca (hapësira) minimale (me përjashtim të vagonëve E dhe Roos).

50 cm | 0 cm

6. Pakot ngarkohen në maksimum: 2 rreshta.

7. Pakot duhet të dalin jashtë takove të paktën 50 cm.



Sigurimi

Stiva duhet

- Të sigurohen nëpërmjet perdeve, spondave dhe krahëve.

8. Lartësia efektive e perdeve, spondave dhe krahëve të paktën 10 cm.

9. Të sigurohen nëpërmjet të paktën 2 lidhjeve (forca minimale këputëse të paktën 10 Kn).

10. Lidhja bëhet afërsisht 50 cm larg nga fundi i stivës.

Kur sigurimi bëhet nëpërmjet të paktën 2 krahëve.

11. Stiva duhet të dalë jashtë qendrave të krahëve në drejtimin gjatësor të paktën 50 cm

50 cm | 30 cm

12. Në mungesë të çiftit të krahëve ose kur nuk është në pajtim me pikën 10, sigurimi bëhet me lidhje indirekte të veçantë, me forcë këputëse të paktën 40 kN.

13. Sigurimi anësore bëhet me tako të gozhduara, nëse distanca midis stivës dhe krahëve anësore është më tepër se 10 cm; totali i numrit të gozhdëve me diametër 5 mm poshtë secilës anë; 1 gozhdë për 1.500 kg peshë të ngarkesës, për minimumi të paktën 2 gozhdë për tako.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shihni nenet 2 dhe 3.

Neni 43

Traversa druri të palidhura

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Traversa druri të paimprenjuara dhe të palidhura

Vagonët

Vagonë me perde, sponda ose krahë të fiksuar (E..., K..., L..., Re..., Roos..., Snps...)

Metoda e ngarkimit

Traversat e drurit duhet:


- Të ngarkohen në gjithë gjerësinë e vagonit, me një ose shumë rreshta.

1. Në drejtimin gjatësor ose tërthor të vagonit, jo më lart se lartësia e perdeve ose spondave.

2. Në drejtimin gjatësor të vagonit, jo më lart se lartësia e perdeve ose krahëve.

3. Distanca (hapësira) minimale (me përjashtim të vagonëve E dhe Roos).

30 cm | 0 cm



Sigurimi

Kur sigurimi bëhet nëpërmjet vetëm 2 krahëve në secilën anë.

4. Stiva duhet të dalë jashtë qendrës së krahëve në drejtimin gjatësor, të paktën:

30 cm | 20 cm

5. Në vagonët me krahë, stiva sigurohen me lidhje të dyfishtë.

Forca këputëse e lidhjeve të jetë se paku 40 kN (me pajisje tensionuese).

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Neni 44
Ashkla druri

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Ashkla druri prej llojeve të ndryshme druri

Vagonët


Vagonë me sponda të larta (E..., Ea..., LF..., Tms.)

Metoda e ngarkimit

Ashklat e drurit duhet

- Të shpërndahen uniformisht në të gjithë sipërfaqen ngarkuese.

1. Të ngarkohet me një lartësi 10 cm poshtë lartësisë së spondave (për gjatë gjithë aksin gjatësor të vagonit); ose
2. Të ngarkohet jo më lart se lartësia e spondit (përfshirë dhe aksin gjatësor të vagonit); ose
3. Të ngarkohet në formë koni.



Sigurimi

4. Kur përdoret metoda e ngarkimit sipas pikës 2 ose 3, e gjithë sipërfaqja e ngarkimit duhet të mbulohet: materiali mbulues është sintetik me:

- Dimensione të kuadratit të rrjetës afërsisht 30 mm;

- Forca këputëse¹ të paktën 39 daN në drejtimin gjatësor dhe të paktën 48 daN në drejtimin anësor.

5. Materiali mbulues duhet të lidhet (fiksohet afërsisht çdo 2 m).

- Me lidhëse jometalike (forca këputëse e lidhëseve afërsisht 50 daN).

Lidhëset duhet:

6. Të lidhen te rrjeta; ose

7. Të lidhen mbi rrjetat; ose

8. Të lidhet e tërhiqet te gropat e vagonit (në vagonët Eanos ekzistojnë këto gropat).

Në vagonët Tms ngarkesat sigurohen nëpërmjet mbylljes dhe fiksimit të çatisë së vagonit.

Të dhëna shtesë

Ashklat e drurit nuk duhet të ngjishen.

¹ Testi i shtrëngimit kryhet me një kampion 10 cm të gjerë të ndërthurur 3 herë.

Pllaka kompesatoje e pllaka tallashi

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Pllaka kompesate dhe tallashi të imprenjuar ose të paimprenjuara, lidhur me pako.

1. Lartësia e pakove

- Për pllaka të lëmuara – të imprenjuara afërsisht 60 cm;

- Për pllaka të paimprenjuara afërsisht 100 cm.

2. Lidhëset me anë të mbrojtura, bëhen në distancë afërsisht 1 m, të paktën 2 lidhje në drejtimin gjatësor të pakos (forca këputëse të paktën 14 kN).

Vagonët

Vagonë me dysHEME dërrase dhe nëse është e mundur me perde ndarëse (H..., Li..., Rils..., Si..., T...).

Metoda e ngarkimit

3. Pakot ngarkohen duke i vendosur në tako druri me një ose disa rreshta.



4. Takot dhe traversat bylyk përgatiten prej druri të butë.

- Me seksion tërthor katërkëndësh dhe që shtrihet gjatë faqes së gjerë;

- Prej një cope ose maksimumi tri copash të lidhura dhe që mbulojnë të gjithë gjerësinë e njësisë së ngarkesës.

5. Lartësia e stivës nuk duhet të tejkalojë 180 cm për pllaka të lëmuara – të imprenjuara.

6. Stiva lidhet komplet me dy lidhëse me anë të mbrojtura (forca këputëse e lidhëseve të paktën 22 kN).

**Sigurimi**

- Në drejtimin gjatësor të vagonit.

7. Nëpërmjet lidhjes me perdet ndarëse; ose

Nëpërmjet plotësimit të hapësirave të ndërmjetme.

- Në drejtimin tërthor të vagonit.

8. Nëpërmjet takove të gozhduara në vend, me të paktën 2 për stivë në çdo anë.

Takot duhet të kenë të paktën 5 cm trashësi me një lartësi efektive të paktën 3 cm; numri i gozhdëve me diametër 5 mm në tako e secilën anë; 1 gozhdë për 1.500 kg peshë të ngarkesës; ose

9. Nëpërmjet të paktën 2 lidhjeve indirekte për stivë me pajisje tensionuese dhe mbrojtëse të anëve (forca këputëse e lidhëseve të paktën 40 kN).

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Torfa (materiale ushqimore të dekompozuar) dhe substanca të tjera të ngjashme me ballo të presuara

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Torfa dhe substanca të ngjashme me ballo të presuara.

Vagonët

Vagonë me perde ose sponda dhe krahë (E..., K..., Re...).


Metoda e ngarkimit

Ballot ngarkohen me rreshta të lartësisë së njëjtë, të vendosura të ngjeshura njëra mbas tjetrës për sa është e mundur dhe stivohen në formë kryqi në stivë.

Ballot anësore të secilit rresht vendosen përkundrejt perdeve ose krahëve.

Rreshti i fundit (i sipërmi) përbëhet vetëm nga një rresht ballos, të vendosura tërthorazi mbi rreshtin e mëposhtëm, kështu kjo bën një veprim të lidhjes indirekte të gjitha ballove.

1. Ngarkesa mbulohet me mushama, e cila vendoset (futet) midis ngarkesës dhe krahëve ose perdes (spondit) ballore të vagonit.



Sigurimi

2. Në qoftë se rreshtat nuk janë mbështetur në një lartësi të paktën 10 cm poshtë lartësisë maksimale të perdeve ose spondave, ngarkesa duhet të sigurohet me lidhje indirekte në vagonë duke kaluar mbi mushama në drejtimin gjatësor dhe dy herë në drejtimin tërthor me shirita jometalikë (forca këputëse të paktën 10 kN).

3. Ngarkesa në vagonët e sheshtë sigurohet në fundet e vagonit me dy lidhje oblike.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës dhe gabariti i ngarkesës: shihni nenin 3 dhe 5.

PRODHIME LETRE

Rulona letre, të ngarkuar përkundrejt sipërfaqes cilindrike

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Rulona letre


Vagonët

Vagonë me dyshe me dërrase dhe perde rrëshqitëse dhe me manovrim mekanik të perdes dhe sponda ballore fikse (H..., Li..., Rils..., Si...).

Metoda e ngarkimit

1. Në një ose shumë grupe, në një ose shumë radhë, në mënyrë që të mbulojë, brenda mundësive, sa më shumë sipërfaqen e vagonit.

2. Në maksimum me dy rreshta të vendosur në sistem bishtdallëndysheje, duke vendosur në rreshtin e poshtëm rulonat me diametër më të madh.



Sigurimi

Në drejtimin gjatësor të vagonit

- Rulonat në rreshtin e poshtëm sigurohen:

3. Nëpërmjet spondave ballor të vagonit (hapësirat plotësohen me elemente të përshtatshme); ose

4. Nëpërmjet vendosjes së takove në rulonat fundorë, këto tako janë metalikë dhe në konstruktion (pjesën mbështetëse) kanë godronime (sipërfaqe të ashpërsuar). Këto për çdo rulon ose ndryshe.

5. Duke përdorur tako druri, që vendosen në dy fundet dhe në çdo 3 deri 4 rulona.

* 2 tako në çdo vend kur ruloni është jo më i gjërë se 1.5 m dhe 4 tako në çdo vend ku ruloni është më i gjërë se 1.5.

*Lartësia e takove: 15 cm për rulona me diametër deri 80 cm, 20' cm për diametër më të madh se 80 cm.

* Gjerësia e takove: afërsisht 20 cm, këndi i takos afërsisht 35°.

* Numri total i gozhdëve (diametër 5 mm) në çdo drejtim të rrotullimit (lëvizjes).

1 gozhdë/1500 kg

1 gozhdë /3000 kg

* Të peshës së ngarkesës, me të paktën 2 gozhdë për tako.

* Rulonat në rreshtin e sipërm sigurohen.

6. Nëpërmjet ngarkimit në sistem bishtdallëndyshe (diametri i rulonave të rreshtit të sipërm nuk duhet të jetë më i madh se diametri i rulonëve të rreshtit të poshtëm).

7. Në se rulonat kanë prirje të dëmtohen në fundet (ballot) e vagonëve vendosen pajisje me materiale amortizuese, siç tregohet në figurë.

8. Në drejtimin anësor të vagonit, rulonat e rreshtit të sipërm sigurohen nëpërmjet dy takove prej materiali me koeficient fërkimi të rritur (p.sh. tako prej kauçuku ose kauçuk i granluar ose shajak i imprenjuar) me një minimum $\mu = 0.75$, që vendosen afërsisht 15 cm nga fundi i rulonit.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Neni 48

Rulona letre të ngarkuar njëra mbas tjetrës

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

* Rulona letre

Vagonët





* Vagonë me perde rrëshqitëse, manovrim e perdes mekanike, me çati të hapshme, sponda, krahë ose perde fundore fikse (H..., Kils..., Li..., Rils..., Si..., Ta..., Tb..., Tm...).

Metoda e ngarkimit

1. Në një ose shumë grupe, të mbulojnë brenda mundësive sa më shumë sipërfaqen e vagonit.

2. Deri në maksimum me dy rreshta të vendosur në sistem bishtdallëndysheje, dhe rulonat me diametër më të madh të vendosen në rreshtin e poshtëm.

3. Rulonat nuk duhet të takojnë dyert, perdet rrëshqitëse, spondat me krahë të shkurtër, spondat ose krahët.



Sigurimi

Në drejtimin gjatësor të vagonit, rulonat e rreshtit të poshtëm sigurohen:

* Njëpërmjet spondave ballore ose perdeve;

* Kur ngarkesa është vendosur në sistem bishtdallëndyshe, rulonat e fundit të rreshtit të sipërm sigurohen njëpërmjet spondit ballor ose njëpërmjet krahëve fundore.

4. Nëse është e nevojshme lidhen së bashku, ose ndryshe.

5. Njëpërmjet vendosjes së rulomit të sipërm në mënyrë të tillë që aksi tërthor i tij të koencidojë me vendin e bashkimit të rulonave të poshtëm (shih figurën).

6. Në drejtimin tërthor të vagonit, duhet të vendosen të paktën 2 tako në çdo rulon të rreshtit të poshtëm, takot duhet të takojnë me spondat njëpërmjet fundeve të tyre të rrumbullakosura.

- Lartësia e takos është sa $1/12$ e diametrit të rulomit, por jo më pak se 12 cm;

- Lartësia e takos është afërsisht 20 cm, me kënd afërsisht 35° ;

- Numri total i gozhdëve (diametri 5 cm) në secilin drejtim të lëvizjes: 1 gozhdë /1500 kg të peshës së ngarkesës, minimumi 2 gozhdë për tako.

Për rulonat e vendosura në një grup, njëra mbas tjetrës ose njëra e vendosur në pjesën e sipërme mbi tjetrën, merret pesha totale e grupit

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Neni 49

Rulona letre, ngarkuar vertikalisht

1. Zgjedhja e vagonit

Vagonë me sponda anësore dhe ballor, dyshme dërrase pa hambar

2. Ngarkimi, vendosja në vagon

Rulonat diametri i të cilave është i barabartë ose më i madh se $5/10$ e lartësisë së tyre, ngarkohen me një ose disa grupe dhe vendosen si më poshtë përcaktohet:

2.1 Në një grup që është në kontakt me spondat ballore).

2.2 Në një grup që mund të zhvendosen në drejtimin gjatësor. Hapësira e lire është 50 cm përkundrejt spondave ballore.

2.3 Në dy grupe, që janë në kontakt me spondat ballore me një hapësirë të lirë në mes të vagonit, që të paktën duhet të jetë një metër.

Rulonat vendosen në kontakt (ngjitur) me njëri-tjetrin, dhe në kontakt me spondat anësore ose spondat ballore.

Në vartësi nga diametri i tyre, mund të ngarkohen duke iu përshtatur dimensioneve të tyre dhe vendosja e tyre është e pranueshme vetëm kur rulonat janë në kontakt me spondat anësore.

3. Sigurimi

3.1 Rulonat sigurohen kundrejt zhvendosjes anësore nëpërmjet spondave anësore, lëkundjet e rrëzimet evitohen duke i ngarkuar në grup (në kontakt me njëri-tjetrin), ose nëpërmjet spondave ballore.

3.2 Rulonat, diametri i të cilëve është më i vogël se $7/10$ i lartësisë së tyre, dhe që ngarkohen në vagonë të sheshtë, e që nuk plotësojnë të gjithë sipërfaqen e ngarkimit të vagonit sipas grupimit që i është bërë, duhet të lidhen në unitete (një njësi).

Neni 50

Rulona letre dhe brumë druri, të ngarkuara vertikalisht

Vagonë individuale dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonë me amortizator me kors të gjatë


Tipi i mallit

Rulona letre dhe brumë druri me diametër të paktën $5/10$ të lartësisë së rulonave ose të stivës.

a) Rulonat ngarkohen me një ose shumë rreshta, lartësia e përgjithshme nuk duhet të kalojë lartësinë e perdeve të lëvizshme.

b) Rulonat mund të ngarkohen në disa rreshta, lartësia e të cilave nuk tejkalon lartësinë e perdeve të lëvizshme, me një rresht plus të ngarkuar në qendër në pjesën e sipërme në zonën e kurbuar të çatisë, në qoftë se rreshtat e mëposhtëm janë vendosur në një linjë (rresht i drejtë).

c) Rulonat ngarkohen në një ose shumë rreshta, lartësia totale e tyre nuk tejkalon lartësinë e perdeve lëvizëse.




Vagonët

Vagonë me karretë ose vagonë të shumëfishtë (të lidhur) me perde të lëvizshme të përforcuara dhe sponda ballor fiks (shihni shtojcën)

Metoda e ngarkimit

1. Rulonat ngarkohen në formacion kompakt, të vendosura ngjitur me njëra-tjetrën, në një ose disa rreshta, me rresht të mëposhtëm në kontakt me spondat ballor dhe duhet të shfrytëzojnë maksimalisht sipërfaqen ngarkuese.

2. Hapësira anësore përkundrejt perdeve lëvizëse: maksimumi 10 cm.
3. Kur është i ngarkuar sipas variantit (b), hapësira anësore midis rreshtave dhe perdeve lëvizëse në pjesën e kurbuar të çatisë duhet të jetë më e madhe se 10 cm.
4. Kur është e ngarkuar sipas variantit (c), distanca deri te perdet duhet të jetë afërsisht e njëjtë në të gjithë anët dhe më e madhe se 10 cm në pjesën e kurbuar.
5. Në drejtimin gjatësor, duhet të lihet një hapësirë në mesin e vagonit; kur ngarkimi bëhet në disa rreshta, hapësira lihet në rreshtin e sipërm.
- * Rulonat vendosen si përcaktohet në vijim
6. Në radhë e në kontakt me njëra-tjetrën (dhe radha tjetër i përshtatet të parës) kur diametri i rulonave nuk është më i madh se $\frac{1}{2}$ e gjerësisë së ngarkimit; ose
7. Në radhë në formë hapash kur diametri i rulonave është më i madh se $\frac{1}{2}$ e gjerësisë së ngarkimit (gjerësia e sipërfaqes së ngarkimit); ose
8. Në shumë radhë në formë hapash, kur diametri i rulonave është më i vogël se $\frac{1}{2}$ e gjerësisë së ngarkimit.



Sigurimi në drejtimin gjatësor të vagonit:

9. Nëpërmjet perdeve fundore
10. Kur ka një hapësirë më të madhe se 50 cm në qendër të vagonit, lidhen së bashku disa rulona me shirita vetëngjitës (forca këputëse 1.000 daN minimale) ose sigurohen kundrejt rrëshqitjes.
- Në drejtimin tërthor të vagonit
11. Ngarkuar sipas (a) nëpërmjet perdeve rrëshqitëse.
1. Ngarkuar sipas (b) nëpërmjet perdeve rrëshqitëse, me rresht të sipërm që ndodhet në zonën e kurbuar të siguruar nëpërmjet elementeve plotësues me koeficient të lartë fërkimi.
2. Ngarkuar sipas (c) nëpërmjet plotësimit të hapësirës anësore ose vendosjen e drejtuesve ose nëpërmjet elementëve plotësues me koeficient të lartë fërkimi.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Koeficienti fërkimit të elementeve plotësuese $\mu = 0,70$.

SHTOJCË

VAGONË ME KONSTRUKSION TË PËRFORCUAR ME PERDE RRËSHQITËS

(Në pajtim me kërkesat e larta të fishës UIC 577 të datës 1.7.1994, ERRI RP 17, edicioni i mëparshëm 7.)

UIC Kod numër	Pronari ose Hekurudha	Vagonët	
		Germat e Kodit	Numri
68	AAE	Habbins	31 68 277 0 000 -999
		Habbins	31 68 277 1 000 -999
		Habbins	31 68 277 2 000 -999
		Habbins	33 68 277 0 000 -999
		Habbins	33 68 277 1 000 -999
		Habbins	33 68 277 2 000 -999
		Habbillns	31 68 278 0 000 -999
		Habbillns	33 68 278 0 000 -999
		Habbillns	33 68 287 0 000 -500
74	SJ	Habins	34 74 278 2 000-405
		Laaais	24 74 435 9 151-910
		Laaais	24 74 436 0 000-399
		Laaais	24 74 460 0 200 399
80	DB	Habbins	33 80 277 0 000-719
		Habbins	33 80 278 1 300-449
		Habis	33 80 275 2 900-949
		Habis	33 80 275 5 900-919
		Habis	33 80 275 5 000-189
		Habills	33 80 275 6 000-119
		Habis	33 80 276 3 690-709
		Habis	33 80 276 3 000-199
		Habins	33 80 278 2 500-649
		Habins	34 80 276 3 490-589
		Habbins	33 80 277 1 000-699
		Habis	33 80 278 2 000-099
		Habins	33 80 278 2 200-449
		Habins	33 80 278 2 750-999
		Habins	33 80 278 3 500-599
		Habins	83 80 278 2 650-749
		Habis	83 80 276 2 200-339
		Habins	83 80 278 3 000-499
		Habins	83 80 278 3 600-850
		Habis	34 80 275 5 476-595
		Habis	34 80 275 3 458-507
		Habis	33 80 276 2 750-889
		Habis	33 80 275 3 508-977
		Habis	83 80 275 5 190-475
		Habis	83 80 275 3 978-991
		Hirrs	83 80 275 5 596-775
		Hirrs	23 80 292 1 300-599
		Hirrs	23 80 292 1 650-749
		Hirrs	23 80 292 1 775-799
		Hirrs	43 80 292 1 750-774
		Hirrs	43 80 292 1 800-849
		Hirrs	23 80 292 1 850-999
		Hirrs	23 80 292 1 800-999
		Laaaims	23 80 432 2 000-099
		Laaaims	43 80 432 2 000-013
		Laakkips	23 80 433 8 000-163

		Lalps Sins Sins Sins Sins	23 80 431 2 164-303 33 80 463 8 002-251 33 80 463 8 452-481 34 80 463 8 252-451 34 80 463 8 482-501
81	OBB	Habbins Habbillns Habbins Habbillnss	31 81 277 1 200-399 31 81 278 0 500-579 31 81 287 0 000-199 31 81 289 0 000-079
83	FS	Habills Habilss	31 83 285 2 000-714 31 83 285 2 800-899
86	DSB	Habins	31 86 278 3 000-063
87	SNCF	Habbillss Habbillss	81 87 288 0 001-149 81 87 288 0 800-849
88	SNCB	Habins	35 88 278 2 800-999

Neni 51

Rulona letre, të ngarkuar njëra mbas tjetrës (pozicion horizontal)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar Vagonë me amortizator me kors të gjatë
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Rulona letre


Vagonët

Vagonë me perde rrëshqitëse, me manovrim mekanik të perdes dhe spond ballor të fiksuar (H..., Kils..., Li..., Rils..., Si...) dhe të pajisur me pajisje speciale për fiksimin e takove (fole për krahët, vrima për bulonat poshtë perdeve ndarëse, me rrëshqitës të shkallëzuar etj.).

Metoda e ngarkimit

Rulonat ngarkohen

1. Në një rresht të vetëm
2. Pa kontakt me perdet lëvizëse, me pjesët e tjera ose krahët
3. Vendosen njëra mbas tjetrës



Sigurimi

- Në drejtimin gjatësor të vagonit
- 4. Nëpërmjet spondave ballore ose perdeve, me mundësi rrëshqitje.
- Në drejtimin tërthor të vagonit.
- 5. Nëpërmjet takove (tako të godronuara etj.) të fiksuar në vagon.
- Lartësia e takos të paktën 20 cm;
- Me gjerësi të mjaftueshme për të siguruar vetstabilitetin e takos, që të mbrojë ngarkesën dhe të moslejojë lëvizjen në drejtimin gjatësor.
- Këndi i takos, afërsisht 45° , cepat (anët) e rrumbullakosura.
- 6. Distanca nga aksi (qendra) i takos deri te fundi i rulonit të paktën 50 cm.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Neni 52

Brumë druri me dengje (dengje individuale)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Brumë druri në dengje, të lidhura në drejtimin gjatësor e tërthor me shirita (forca këputëse e lidhjeve të paktën 7kN)

Vagonët


Vagonë me sponda ose krahë (K..., La..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

Dengjet ngarkohen

1. Të shpërndara uniformisht në gjithë sipërfaqen e ngarkimit, kudo që ekziston mundësia pa hapësirë.

2. Në rreshta me lartësi të njëjtë, në stiva simetrike.



Sigurimi

3. Çdo stivë sigurohet me lidhje indirekte (forca këputëse minimale 10 kN).

4. Stiva e parë dhe e dytë nga fundi i ngarkesës duhet të lidhet në mënyrë diagonale, në qoftë se rreshtat nuk janë të siguruara mjaftueshëm nëpërmjet krahëve fundor.

5. Çdo rresht, i cili nuk është i siguruar në mënyrë të mjaftueshme nëpërmjet spondave ose krahëve duhet të lidhen së bashku rreth e përqark me shiritin.

6. Dengjet në çdo rresht që dalin jashtë krahëve, duhet të lidhen së bashku në drejtimin gjatësor e tërthor; forca këputëse e lidhjeve duhet të jetë së paku 10 kN.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Neni 53

Brumë druri në dengje (në njësi)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

Brumë druri në dengje, të lidhura në drejtimin gjatësor e tërthor me shirita

1. 6 ose 8 dengje lidhen së bashku në formën e një njësie ngarkuese, jo më e lartë se 190 cm (forca këputëse e lidhjeve të paktën 7 kN)

Vagonët

Vagonë me sponde ose krahë (K..., La..., R..., S...)


Metoda e ngarkimit

Njësitë e ngarkesës duhet:

2. Të shpërndahen në mënyrë uniforme, pa hapësira, në tërë sipërfaqen e ngarkesës.

3. Në pjesën fundore, të paktën një radhë e vendosur në mënyrë gjatësore.

4. Vendosen në mënyrë gjatësore ose tërthore në vagon.



Sigurimi

5. Dengjet e sipërme të njësisë së ngarkesës duhet të lidhen me një shirit, për të siguruar ato nga vetë rrëshqitja.

6. Njësitë e ngarkesës afër njëra-tjetrës duhet të lidhen së bashku; ose

7. Krahët lidhen së bashku horizontalisht me pjesën e sipërme të tyre, kjo lidhje kalon në çdo krahë (duke bërë nyje). Forca këputëse e lidhjeve duhet të jetë së paku 10 kN.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

GURË DHE MATERIALE NDËRTIMI

Neni 54

Bloqe guri (të përpunuar)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh | Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar

Tipi i mallit

Bloqe guri (të përpunuar)

Vagonët

Vagonë me perde, sponde dhe krahë me dysHEME dërrase (E..., K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

1. Bloqet ngarkohen në një ose dy rreshta, vendosen përgjatë faqes së gjerë, dhe sipas mundësisë shpërndahen në gjithë sipërfaqen ngarkuese, me ose pa hapësira të ndërmjetme

2. Vendosen shtrirë në dyshtet e vagonit; ose

3. Vendosen në një pozicion stabil në pajisje të veçantë druri (trashësia e dërrasave të pajisjes 1 deri 4 cm).

Stiva e blloqeve të gurit bëhet e tillë që midis dy blloqeve vendosen dërrasa në drejtimin tërthor, gërsheta kashte ose litar të trashë/kabllo dhe lidhjen së bashku të paktën dy herë, duke formuar një njësi ngarkese (forca këputëse e lidhjes të paktën 14 kN)


4. Distanca (hapësira) minimale

Me sipërfaqe mbështetëse të lëmuara 50 cm

30 cm

Me sipërfaqe mbështetëse të ashpër 30 cm

20 cm



Sigurimi

Bloqet sigurohen nëpërmjet perdeve të vagonit, spondave ose prej së paku 2 krahëve

6. Kur sigurohen prej së paku 2 krahëve, bloqet duhet të dalin në drejtimin gjatësor përtej akseve të krahëve të paktën

(me sipërfaqe mbështetëse të lëmuara) 50 cm

30 cm

(me sipërfaqe mbështetëse të ashpër) 30 cm

20 cm

7. Nëpërmjet pajisjeve drejtuese kur nuk janë në pajtim me pikën 6 ose kur bloqet e gurët janë me tepër se 10 cm larg perdeve, spondave ose krahëve

- Pajisjet drejtuese duhet të kenë trashësi të paktën 5 cm, me një lartësi efektive të paktën 3 cm,

- Numri total i gozhdëve me diametër 5 mm, përgjatë secilës anë: 1 gozhdë/1500 kg, por të paktën 2 gozhdë për pajisje drejtuese

Bloqet ¹⁾, të cilët nuk janë siguruar direkt në drejtimin anësor nëpërmjet perdeve të vagonit, spondave ose krahëve duhet të sigurohen nga ana anësore nëpërmjet pajisjeve drejtuese.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

¹⁾ Me përjashtim të blloqeve me sipërfaqe mbështetëse të ashpër.

Neni 55

Bloqe guri (të papërpunuar)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

Bloqe guri të papërpunuar (me sipërfaqe të ashpër)

Vagonët

Vagonë me perde, sponde dhe dysHEME druri (E..., K..., Re...)

Metoda e ngarkimit

Bloqet ngarkohen shtrirë në vagon


- Kur është e mundur shpërndahen në të gjithë sipërfaqen e ngarkimit, me ose pa hapësira të ndërmjetme.

1. Vendosen përgjatë sipërfaqes së gjerë në vagon dhe formës jo të rregullt të sipërfaqes kompensohen duke përdorur dërrasa për të siguruar një pozicion stabil.

2. Distancat (hapësira) minimale

30 cm

0 cm



Sigurimi

Bloqet sigurohen nëpërmjet aftësive të veta (të ashpërsisë së sipërfaqes) të fërkimit të lartë dhe nëpërmjet perdeve ose spondave të vagonit.

Të dhëna shtesë

Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

Neni 56

Pllaka guri dhe betoni (ngarkimi në pajisje)

Vagonë individuale dhe grup vagonësh	Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar Vagonë me amortizator me kors të gjatë
--------------------------------------	---

Tipi i mallit

1. Pllaka guri dhe betoni të ngarkuara në pajisje me konstrukcion çeliku. Tipi A.

2. Sipërfaqja e pajisjes ku vendosen pllakat ka kënd pjerrtësie rreth 12°.

3. Bazamenti i sipërfaqes pozicionohet tërthorazi, me elemente (tip thumba për mosrëshqitje) të vegjël në sipërfaqen mbështetëse, me lartësi afërsisht 3 mm dhe të vendosura perpendikular me drejtimin e rrëshqitjes.

Vagonët


Vagonë me sponde ose krahë dhe dysHEME druri (E..., K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit

4. Pajisja vendoset në drejtimin gjatësor të vagonit.
5. Vendosen numër i njëjtë pllakash dhe prej të njëjtit dimension në të dyja anët e pajisjes.
6. Pllakat duhet të dalin jashtë pjesëve mbështetëse të pajisjes në të dyja anët rreth 50 cm.
7. Çdo stivë lidhet direkt te pajisja të paktën 2 herë (forca këputëse e lidhjeve të paktën 1.000 daN).
8. Njësitë e ngarkesës mund të vendosen njëra pas tjetrës me një distancë midis tyre të paktën 50 cm.
9. Distanca (hapësira) minimale.

50 cm

0 cm



Sigurimi

10. Pajisjet sigurohen nga ana anësore nëpërmjet pjesëve drejtuese.
 - Pjesët drejtuese kanë trashësi të paktën 5 cm, me një lartësi efektive të paktën 3 cm.
 - Numri total i gozhdëve me diametër 5 mm përgjatë secilës anë është: 1 gozhdë/1500 kg peshë e ngarkesës, por me të paktën 2 gozhdë për pajisje drejtuese.
- Të dhëna shtesë
Shpërndarja e ngarkesës: shihni nenin 2.

MJETE DHE MAKINERI

Neni 57

Mjete dhe makineri me rrota ose zinxhirë, sigurimi me tako

Vagonë individualë dhe grup vagonësh

Vagonët me trena bllok dhe transport të kombinuar
Vagonë me amortizator me kors të gjatë

Tipi i mallit

Automjete, kamionë, trajlera, ekskavator, buldozerë, vinça

- Mjetet me mushama duhet të mbyllen e sigurohen
- Antenat duhet të mblidhen ose hiqen

Motorët e mjeteve duhet të sigurohen nga ndonjë ndezje spontane

- Gomat të jenë të fryra në presion normal pune

Vagonët

Vagonë me dysHEME dërrase (K..., L..., R..., S...)

Metoda e ngarkimit


